



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM**

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:  
“Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë  
“Universiteti i Sporteve të Tiranës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Marjana SINANI**

**Dr. Genc BURAZERI**

**Shkurt / 2020**

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TE PROGRAMIT

### Përshkrim përmbledhës

Universiteti i Sporteve të Tiranës, ka një strukturë të konsoliduar ndër vite. Është institucion i arsimit të lartë me traditë 60 vjecare, i njohur fillimisht me emrin Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 123 datë 17.02.2010, Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” emërtohet Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST). UST është i vetmi institucion i arsimit të lartë i këtij lloji në Republikën e Shqipërisë në funksion të përgatitjes të mësuesve të Edukimit Fizik dhe Shëndetësor, përfshirë dhe fusha të specialistëve të sportit. Ky institucion ofron studime në të tri ciklet: Bsc, MP/MSc dhe nivel Doktorale kualifikim të plotë në fushat e sportit e të shëndetit.

Universiteti i Sporteve të Tiranës” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.64, date 21.09.2017, me kohëzgjatje 3 vite akadmeike, me afat vlefshmërie deri në 30.09.2020.

Aktualisht Universiteti i Sporteve të Tiranës përbëhet nga 3 (tre) fakultete:

#### 1. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes me:

- Departamenti i Mjekësisë Sportive;
- Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit;
- Departamenti i Sportit;

#### 2. Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit me:

- Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit;
- Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit;
- Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreacionit dhe Turizmit;

#### 3. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit me:

- Departamenti i i Disiplinave Biomjekësore dhe Humane;
- Departamenti i Kineziologjisë;
- Departamenti i Rehabilitimit;

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes u ngrit mbi përvojën e krijuar nga Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” mbi bazën e VKM, Nr. 266, dt. 25.05.2000. FSHL – ja përbëhet nga tre njësi bazë, respektivisht Departamenti i Sporteve, Departamenti i Mjekësisë Sportive si dhe Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, , i cili është përgjegjës për programin e studimit. Në njësinë kryesore FSHL, ofrohen programe studimi të të tre cikleve të studimeve: Bachelor, Master Profesional, Master Shkencor dhe Doktoraturë.

Objekti i këtij vlerësimi të jashtëm është programi i studimit me kohë të plotë i ciklit të dytë Master Profesional, në: “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar” i ofruar nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit.

Ky program është licencuar fillimisht si program Master Profesional në “Mësuesi për Arsimin e Mesëm në lëndën Edukim Fizik” me urdhër të Ministrit Nr. 611, datë 31.12.2010, i cili realizohej me 60 kredite dhe kohëzgjatje normale 1.5 vite akademike.

Duke u mbështetur në hapësirën ligjore të krijuar me ndryshimet në legjislacionin e ri për arsimin e lartë, të rrjedhura nga Ligji Nr 80/2015 dhe VKM Nr.41, datë 24.01.2018, për vitin akademik 2018-2019, ky program studimi ofrohet i përshtatur dhe me emërtimin e ri Master Profesional në: “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”, në përputhje me vendimin e Bordit të Akreditimit Nr.125, datë 15.12.2017, dhe me Urdhër të MASR Nr.15, datë 11.01.2018.

Ky program synon të realizojë përgatitjen e plotë të mësuesve në lëndën e EF e Shëndetësor për sistemin arsimor parauniversitar. Në këtë program studimi përveç gruplëndëve karakterizuese që synojnë transmetimin e njohurive të kurrikulës lëndore specifike, një vend shumë të rëndësishëm në planin mësimor të këtij program studimi zënë lëndët me karakter psikosociale dhe ato që theksojnë tërësinë e problematikave që edukojnë shëndetin. Ky program vjen mjaft i sofistikuar me ndikim të drejtëpërdrejtë në formimin profesional të mësuesve të ardhshëm në sistemin arsimor parauniversitar. Ky program është hartuar dhe konceptuar duke u bazuar edhe në linjat e përgjithshme të kurrikulave të vendeve të ndryshme të BE –së. Programi është konceptuar në përputhje me karakteristikat ekonomike të vendit tonë, pra duke gjetur një përputhshmëri të plotë me tregun e punës. Studentët të cilët përfundojnë me sukses Masterin Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” kanë mundësi të shumta punësimi, si në sistemin arsimor jopublik ashtu edhe në atë publik, në të gjithë ciklet e arsimit parauniversitar. Ata gëzojnë të drejtën të ndjekin shkollën doktoale në fushat respektive.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Procesi i Vlerësimit të Jashtëm është realizuar me rigorozitet nga ana e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të përcaktuar paraprakisht nga Bordi i Akreditimit që funksionon pranë ASCAL.

Qëllimi kryesor i procesit të vlerësimit të jashtëm është identifikimi i nivelit të përmbushjes së standardeve shtetërore të cilësisë për arsimin e lartë të përcaktuara me VKM nr. 531, date 11.09.2018 për programin e studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”. ASCAL bazuar në “Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017”, ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga UST, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Asoc. Mariana Sinani, dhe Dr. Genc Burazeri. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demirmeli.

GVJ, u njoh me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm të përgatitur nga Grupi i Vlerësimit të Brendshëm të ngritur nga vetë institucioni. GVJ konsultoi me vëmendje dhe përgjegjësi të

Adresa: “Rruga e Durrësit”

Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: [www.ascal.al](http://www.ascal.al)

E-mail: [info@ascal.al](mailto:info@ascal.al)

gjithë dokumentacionin shoqërues të RVB të dorëzuar paraprakisht në ASCAL nga ana e Universitetit të Sporteve për programin e studimit që synon të akreditojë. Komponent i rëndësishëm i këtij procesi ishte vizita e planifikuar në institucion referuar agjendes. GVJ zhvilloi takime dhe bashkëbiseda të qëllimta me fokus specifik me Dekanin; Përgjegjësin e Departamentit; Grupin e Vlerësimit të Brendshëm; personelin akademik të angazhuar në programin e studimit; studentë që ndjekin këtë program studimi si dhe vizita në sekretari, mjediset fizike, infrastrukturën, sallat e trajtimit fizik e shëndetsor, bibliotekën, ambiente të tjera të këtij institucioni. Në të gjitha takimet duke ju referuar RVB, GVJ parashtrroi pyetje specifike në cdo takim për standardet përkatëse të RVJ si dhe momentet e paqarta nga dokumentacioni paraprak i konsultuar. Për çështje të vecanta, GVJ mori përgjigje dhe gjeti arsyetime të detajuara nga personat përgjegjës. Ky proces u pasurua me dokumentacion shtesë nga ana e drejtuesve të institucionit dhe zyrat përkatëse të institucionit.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 04.02.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36/2 Prot, datë 04.02.2020. Universiteti i Sporteve të Tiranës përcjell pranë ASCAL më datë 13.02.2020 nëpërmjet shkresës me Nr. 214/1 Prot, date 13.02.2020 përgjigje në lidhje me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”**

**I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT**

**Standardi I.1**

**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion si dhe në takimet e realizuara në Universitetin e Sporteve të Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, konfirmojmë se programi, organizohet në përputhje me ligjin dhe përmbush interesat kombëtare të vendit dhe specifikisht është në sinkron me detyrimet kurrikulare për përgatitjen dhe formimin e mësuesit specialist në lëndën e edukimit fizik e shëndetësor me njohuri dhe aftësi të thelluara në këto fusha si dhe përgatitjen e tyre etike dhe profesionale si mësues të ardhshëm të Edukimit Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar. Ky kriter u referua qartë në takimet e bëra qëllimshëm me Dekanin e fakultetit,

	<p>Përgjegjësini e Departamentit që ofron programin, stafi pedagogjik dhe kërkimor si dhe vetë studentët.</p> <p><i>(Statuti i UST, Kreu V, Neni 26, pika 3;)</i></p> <p><i>(Rregullore e UST, Kreu I, Neni 36, pika 8)</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.</p>	<p>Priremi të besojme se: ky program studimi është hartuar dhe riorganizuar mbi një përvojë të gjatë institucionale, mbi vlera akademike dhe kërkimore shkencore. Universiteti i Sporteve të Tiranës, përfaqëson një prej institucioneve akademike me një përvojë unike në vend në përgatitjen e mësuesve dhe specialistëve në fushën e edukimit fizik, sportit dhe shëndetit.</p> <p>Programi i studimit në fjalë është mjaftueshmërisht i konsoliduar.</p> <p><i>(Ref. - Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”, Kreu II, Neni 6).</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur si dhe vizitës në institucion, rezulton se ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit, për të përgatitur profesionistë në fushën e mësuesisë në EF dhe specialistëve të sportit.</p> <p>Programi në fjalë është në rezonancë të plotë me qëllimin dhe misionin e institucionit.</p> <p><i>(Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p> <p><i>(Ref-Statuti i UST)</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.</p>	<p>E konfirmojmë se: ky program studimi i përgjigjet nevojës së tregut, për përgatitjen dhe formimin e mësuesve specialist në lëndën e edukimit fizik e shëndetësor me njohuri dhe aftësi të thelluara në këtë fushë, përgatitjen e mësuesve me një kuptim të qartë për institucionin shkollor, për vendin dhe shoqërinë e sotme. Të diplomuarit, priremi të besojmë se: do të kenë aftësi dhe njohuri për t'u punësuar në sistemin arsimor parauniversitar si mësues të edukimit fizik e shëndetësor.</p> <p>Programi në fjalë vjen si vlerë e shtuar në treg, referuar ndryshimeve në kurrikulën parauniversitare ku numri i orëve mësimore në këtë disiplinë ka kaluar nga 2 orë në jave, në 3 orë.</p> <p><i>(Ref. – Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve master, “Mësuesi në EF</i></p>

	<i>e shëndetësor në AP”)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.2

**Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.	Priremi të konfirmojmë se: Institucioni është qartësisht i fokusuar në përgatitjen dhe formimin e mësuesit me profil në edukim fizik dhe shëndetësor. Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të vënë në dispozicion ( <i>Misioni dhe Objektivat Strategjike të FSHL</i> ), rezulton se objektivat e zhvillimit të institucionit përshtaten me objektivat e vetë programit. Programi në fjalë, ofron grup-lëndë të detajuara, të specializuara e të përditësuara në EF e shëndetësor, me synim profilizimin specifik të studentëve me kompetenca profesionale. Ky program është vlerë e shtuar në zhvillimin e brendshëm të institucionit. Programi në fjalë e ushqen mjaftueshmërisht titullin e Diplomës.  <i>(Ref. – Plani Strategjik i FSHL, pika 2)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.	Konfirmojmë se në statutin dhe rregulloren e institucionit, dukshëm dhe specifikisht bie në sy misioni strategjik i institucionit UST, i cili synon që:  programet lëndore teorike dhe praktike të harmonizuara me njëra – tjetrën, të përgatisin profesionalisht specialistë të lartë në fushat e edukimit fizik dhe shëndetësor, në përputhje me tregun konkurrues të punës si dhe kërkesat e nevojat e shoqërisë në zhvillim.  <i>(Ref. – Statuti i UST, Neni 7)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	Emërtimi, organizimi, si edhe përmbajtja e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” është në përputhje me fushën akademike në të cilën vepron Departamenti i Shkencave Sociale dhe, Edukimit. Sikurse referohet në RVB dhe është konfirmuar në takimet në institucion, Programi Master Profesional në “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” synon

	<p>krijimin e bazave të mira për përgatitjen dhe formimin e mësuesve specialist në lëndën e edukimit fizik e shëndetësor me njohuri dhe aftësi të thelluara në këtë fushë, përgatitjen e mësuesve me një kuptim të qartë për institucionin shkollor, për vendin dhe shoqërinë e sotme. Ky objektivi gjendet në përputhje me qëllimin e vetë institucionit të shprehur në dokumentat kryesore të politikës dhe drejtimit të tij. Emërtimi i programit është në përputhje me fokusin e institucionit dhe të njësisë bazë Departamentit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit. Organizimi i studimeve është në përputhje të plotë dhe në zbatim të Ligjit 80/2015 të IAL.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e UST, Neni 33, 36, 37)</i></p> <p><i>(Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” Neni 9, 10, 13, 14)</i></p>								
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional” hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.</p>	<p>Programi në fjalë, është hartuar në përputhje me strategjinë kombëtare të zhvillimit, duke ju përgjigjur përgjithësisht ndryshimeve socio-ekonomike dhe zhvillimeve që dikton tregu i punës. Konfirmojmë se ky program studimi i pajis studentët me njohuri dhe kompetenca të kërkimit shkencor në fushat përkatëse, si dhe u mundëson kualifikimin e mëtejshëm dhe të vazhdueshëm të të diplomuarve dhe stafit akademik të FSHL – së.</p> <p><i>(Ref.– Plani Strategjik FSHL, pika 3, 4, 5)</i></p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet plotësisht</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

**Standardi I.3**

**Programet e studimit “Master profesional” synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit “Master profesional” kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që</p>	<p>Referuar RVB dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ u njoh me objektivat e Master Profesional në “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” të cilat përcaktojnë qartë formimin e studentëve si mësues e specialist në lëndën e edukimit fizik e shëndetësor me njohuri dhe aftësi të thelluara në këtë fushë.</p> <p>Dimensionet e programit në fjalë konstatojmë të jenë:</p>

<p>karacterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1- Përgatitja e formimi i mësuesit të edukimit fizik e shëndetësor me njohuri, aftësi dhe të kuptuar të thellë të EF e shëndetësor. Kjo disiplinë kalon kufirin e lëndës duke marrë përmasat e dimensionit në edukim, për shkak se ka pikëprerje të më shumë se dy disiplinave shkencore;</li> <li>2- Formimi i mësuesit kompetent kopetencat fizike, kopetencat shëndetësore, kopetencat psikosociale dhe shëndetin mendor. Këto kopetenca vijnë dukshëm në programin në fjalë;</li> <li>3- Mësues me vlera të shëndosha etike e profesionale;</li> <li>4- Mësuesi dhe metodologjia. Kopetenca të mësimdhënjes. Aftësia për planifikim, menaxhim vlerësim të mësimdhënjes në këtë dimension edukimikimi ku pikëpritet edukimi fizik dhe shëndeti;</li> <li>5- Formimi vetjak dhe kuptimi për veten: Studenti që diplomohet në këtë program merr mjaftueshëm njohuri dhe hapësira kurrikulare për performacë e zhvillim vetjak;</li> </ol> <p><i>(Ref.– Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>Konstatuam se: UST ka ngritur dhe ka funksionale mekanizmat e veta për të njohur tregun e punës si: Zyrën e Informimit, të Orientimit dhe të Karrierës së Studentëve e cila mundëson këshillim dhe informim të studentëve rreth programit të studimit si dhe mundësive të punësimit. Gjithashtu funksionon dhe sektori ALUMNI brenda Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me ajshtë, Këshillimit të Karrierës, i cili të mban të dhënat e studentëve të diplomuar si dhe mundësitë e punësimit / trajnimit të pasqyruar në këtë portal. Nga takimi me përfaqësuesit e këtyre dy strukturave konstatuam se grumbullimi i të dhënave për të diplomuarit dhe të punësuarit e studentëve pritet të përcillet nga Drejtoritë Rajonale Arsimore, si dhe nga kontakti që kjo strukturë (Zyra e Informimit, Orientimit dhe Karrierës së Studentëve) mban me studentët e diplomuar. Në këtë program studimi janë diplomuar vetëm një brez studentësh, për këtë arsye akoma nuk disponohet një database përfundimtar të dhënash mbi punësimin e tyre.</p> <p><i>(Ref. – Shkresë Zyrtare Nr. Prot, 1672/1, dt. 15.10.2019 nga Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashhtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI, UST)</i></p>



<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Gjatë gjithë strukturës të programit të studimit, objektivat formues, struktura, si edhe përmbajtja e studimit garantojnë përfitim të dijeve, aftësive, shkathtësive dhe kompetencave të cilat synojnë të formojnë mësues në Edukim Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar. Këto Objektiva i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e tyre. Gjithashtu përmbajtja dhe funksionimi i këtij program studimi konsiston në një mësimdhënie cilësore, profesionale, duke ndërthurur teorikisht mjaftueshëm praktikën me teorinë. Këto shprehen jo vetëm në dokumentat kryesore të programit si: (<i>Rregullore e programit të studimeve</i>), (<i>Planin mësimor</i>), (<i>relacionin shpjegues për miratimin e riorganizimit të këtij program studimi në vitin 2017</i>), por u konfirmuan edhe në takimin me stafin pedagogjik të këtij programi mësimor, ku synim është të përafrohen kërkesat e tregut të punës në dije të nevojshme në këtë fushë studimi duke përfshirë lëndë apo tematika të reja. Studentët përfaqësues gjatë takimit në institucion kanë referuar se e shohin këtë program studimi me interes për arsye se i aftëson ata, dhe ju jep njohuri për t'u punësuar në sistemin arsimor parauniversitar si mësues të edukimit fizik e shëndetësor. Mbajtësi i kësaj diplome, ka të drejtë të pranohet në provimin e shtetit për profesionin e rregulluar.</p> <p>Të diplomuarit për të fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit, duhet të përmbushin tre kriteret:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1) kryerja e praktikës profesionale;</li> <li>2) kryerja e provimit të shtetit;</li> <li>3) regjistrimi në Urdhrin Profesional përkatës;</li> </ol> <p>(<i>Ref. – Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP</i>)</p> <p>(<i>Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” Neni 6, 13, 14</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit GVJ konstaton se, programi i studimit ofron mundësi transferimi të studimeve ndërmjet programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo IAL të tjera sipas procedurave e standarteve të cilat na u konfirmuan edhe nga takimi që patëm me studentet e këtij program studimi. Transferimi i studentëve nga IAL të tjera mundësohet duke patur parasysh numrin e kuotave të përcaktuara sipas bazës ligjore në fuqi.</p>

	<i>(Ref.– Rregullore e UST, Kreu III, Neni 85, 86, 87, 88)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit hartohen në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor” është hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin në fuqi dhe direktivave të BE-së, si edhe duke u mbështetur në përvojën 60 vjeçare të ofrimit nga ky institucion të programeve të cilat mbulojnë fushën e edukimit fizik. Kjo u konstatua përgjatë gjithë vizitës në institucion si dhe nga bashkëbisedat e qëllimta të parashikuara në agjendën e konfirmuar më parë.
<b>Kriteri 6.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, RVB-së, planit mësimor dhe vizitës në institucion konfirmuan se programi i studimit MP në “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” i përfshin tërësisht studentët në aftësimin profesional të tyre, duke ndjekur praktikatat profesionale si një ndër elementët kyç të programit të studimit, sipas udhëzimeve dhe kriterëve të përcaktuar në rregulloren e këtij program studimi. Studentët e kanë të detyrueshme kryerjen e praktikave profesionale dhe gjatë kryerjes së këtij elementi mësimor pedagogu drejtues i tyre mbikqyr këtë proces.</p> <p>Praktika profesionale është e shtrire në të 2 vitet akademike dhe ka:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- 150 orë praktikë mësimore në Edukim Fizik;</li> <li>- 100 orë praktikë mësimore në Edukim Shëndetësor;</li> </ul> <p>Realizimi i saj mundësohet falë bashkëpunimit që UST ka me Drejtorinë Rajonale Arsimore Tiranë. Pas përfundimit të programit, studentët fitojnë të drejtën e zhvillimit të praktikës profesionale (stazhin) sipas legjislacionit në fuqi për profesionet e rregulluara me ligj, e më pas studenti fiton të drejtën e hyrjes në Provimin e Shtetit.</p> <p><i>Por, mbetet në pikëpyetje cilësia e përmbushjes së praktikës profesionale vecanarisht ajo e parashikuar në vitin e dytë, praktika profesionale me fokus edukimin shëndetësor, e cila për hir të së vërtetës nuk ka traditë në sistemin tonë. Mungon sistemi i mentorëve.</i></p> <p><i>(Ref. – Ligj Nr.10 171, dt.22.10.2009, Neni 9, 10, 11;</i>  <i>(Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” Neni 16, 22, 23)</i></p>
<b>Kriteri 7.</b> Në varësi të profilit të institucionit, në programet e	Pas njohjes me programin e studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” u konstatua se ky

<p>ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.</p>	<p>program ofrohet në gjuhën shqipe. Pas takimit me Dekanin dhe Pergjegjesin e Departamentit, u theksua se institucioni ka prioritet përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit me qëllim mobilitetin e studentëve dhe lektorëve në vende të BE dhe anasjelltas.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të kualifikuar në një drejtim të caktuar.</p>	<p>Institucioni ka fleksibilitet në këtë drejtim duke u përshtatur në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe konkretisht duke kaluar nga programi i studimit Master Profesional në: “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”, si një përgjigje reale për kërkesat për kualifikimin e mësuesve të EF dhe Shëndetësor dhe ofrohet rregullisht në cdo vit akademik.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Asnjë përmbushje</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi I.4</b>  <b>Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion japin një informacion të plotë të kapaciteteve dhe burimeve të nevojshme për të ofruar këtë program studimi. Programi i studimit ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes. Stafit akademik efektiv zotëron përvojën e duhur në mësimdhënie për t’u angazhuar në këtë program studimi. Përbërja moshore e stafit akademik është e balancuar gjë që mundëson përçimin e përvojës dhe kualifikimit brenda njësisë. CV-të e stafit akademik pasqyrojnë angazhimin e tyre në shkëmbime dhe kualifikime të shumta jashtë vendit, si dhe botime shkencore në një numër të lartë në revista brenda dhe jashtë vendit. Raport i MASR mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga UST, vërteton se ky institucion ka kapacitete infrastrukturore të mjaftueshme të cilat janë një faktor i rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij program studimi.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Apendix Tabela 1, 2</i>), Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes për vitin akademik <b>2019-2020</b> ka</p>

	<p>gjithsej <b>47 pedagogë</b>, nga të cilët <b>41 janë pedagogë efektiv (PAE)</b> nga ku 7 kanë titullin “Profesorë”, 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 20 kanë gradën Dr., dhe 7 Asistent Lektorë me Msc; dhe <b>0 pedagogë me kontratë (PAK)</b>, dhe <b>6 pedagogë</b> ndihmës akademik.</p> <p>Në mënyrë specifike, nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga Institucioni, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ka në përbërjen e tij tre departamente:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dep i Sportit, ka në përbërjen e tij <b>20 PAE</b> nga ku 16 me tituj/grada;</li> <li>2. Dep i Shkencave Sociale dhe Edukimit, ka në përbërjen e tij <b>13 PAE</b> nga ku 11 me tituj/grada;</li> <li>3. Dep i Mjeksisë Sportive, ka në përbërjen e tij <b>8 PAE</b> nga ku 7 me tituj/grada;</li> </ol> <p><i>(Ref. – Model Raport nga MASR mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga UST;</i></p> <p><i>(Apendix Tabela 1, 2)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacionit, konfirmon se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” është tërësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë Kryesore (FSHL).</p> <p>Realizimi i këtij program studimi mundësohet nga bashkëpunimi i 3 (tre) departamenteve të FSHL dhe përfshirja e stafit akademik të punësuar me kohë të plotë dhe të pjeshme të kualifikuar në fushën e mjekësisë sportive, psikosociale dhe teoriko-metodologjike si dhe në fushën e sportit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>E konfirmojmë se ka një rezonancë të fuqishme dhe pikëprerje mes tri departamenteve, gjë që garanton cilësinë e përmbushjes së programit.</p> <p><i>(Ref. Apendix Tabela 12.1, 12.2, 12.3)</i></p>

<p><b>Kriteri 4.</b> Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.</p>	<p>Programi i ciklit të dytë Master Profesional në “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”, ”, është tërësisht në drejtimin specifik brenda profilit të institucionit.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p><b>Standardi I.5</b>  <b>Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Institucioni zotëron rregullore dhe akte të tjera të nxjerra prej tij ku përcaktohen me saktësi si ndarja e detyrave ashtu edhe përgjegjësia për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit. Nga shyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga Institucioni, takimit me drejtuesin e njesisë bazë dhe stafin akademik, në lidhje me marrëdhëniet e bashkëpunimit me njësitë e tjera bazë, e konfirmojmë se: programi mësimor realizohet kryesisht me mbulimin e personelit akademik të njesisë bazë dhe në lëndë/module specifike bashkëpunon me 2 (dy) njësitë e tjera bazë të këtij fakulteti. Mbarëvajtja e programit të studimit realizohet në mënyrë të koordinuar nga të gjitha instacat drejtuese të UST, të FSHL si dhe strukturave përbërëse të saj si: Zyra e Kurrikulës, Degën e Informacionit Studentor, Sektori i IT etj., nëpërmjet ndarjes së detyrave mes tyre.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Referuar RVB, si dhe takimit me Dekanin e FSHL, UST ka një rrjet bashkëpunëtorësh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe larmi aktivitete si: konferenca, seminare, workshop-e, takime informuese, projekte, universiada por edhe aktivitete komunitare.</p> <p><i>UST ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me disa universitete kombëtare si:</i></p>

	<p>Universiteti i Mjekësisë së Tiranës;  Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan;  Universiteti European i Tiranës;  Albanian University;  <i>UST ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi dhe me disa universitete ndërkombëtare si:</i>  Universiteti i Romës ‘Foro Italico’;  Universiteti i Edukimit Fizik të Budapestit, Hungari;  Universiteti i Vienës, Fakulteti i Shkencave Sportive;  Universiteti i Lubjanës, Fakulteti i Sportit;</p> <p>Por jo të gjitha këto marrëveshje janë me produkte cilësore. Vecojmë marrëveshjen me Universitetin e Rumanise, me të cilin kishin dhe këmbime në nivel studentësh dhe pedagogësh.</p> <p><i>(Ref. – Informacion zyrtar nga Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI;</i>  <i>(Ref. – Vendim Senati Nr 15, dt. 27.02.2018 mbi Miratimin e Marrëveshjeve të bashkëpunimit të UST);</i>  <i>(Ref. – Vendim Senati Nr. 22, dt. 10.04.2019 Marrëveshje Bashkëpunimi me Universitetin e Budapestit, Hungari)</i>  <i>(Ref. – Model Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës për Praktikën Profesionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Nga takimet e realizuara në Institucion si dhe me Përgjegjës të Departamentit, u konstatua se marrëveshjet e bashkëpunimit në këtë Institucion janë në nivel Universiteti. Specifikisht për realizimin e praktikave profesionale në institucionet arsimore parauniversitare, në kuadër të programit të studimit MP “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”, UST ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me: Drejtorinë Arsimore të Qytetit të Tiranës – sot Zyra Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës.</p> <p><i>(Ref. – Model Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës për Praktikën Profesionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>Në paketën që institucioni ka paraqitur, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me: Drejtorinë Arsimore të Qytetit të Tiranës – sot Zyra Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës për kryerjen e praktikës profesionale. Praktika pedagogjike si dimension substancial i këtij programi studimi, është pjesë e të menduarit të stafit akademik.</p> <p>Sasia e orëve të praktikës pedagogjike në këtë program</p>

	<p>studimi është:</p> <p>150 orë praktikë pedagogjike ne Edukim Fizik; 100 orë në Edukim Shëndetësor;</p> <p>Nga takimi me Dekanin e FSHL dhe Përgjegjës in e departamentit u theksua se programi i modulit, “Praktikë pedagogjike në Edukim Shëndetësor” ka nevojë të rishikohet pasi ky modul është një risi në këtë program studimi. Kjo lëndë është e shtrirë në 2 (dy) vite akademike me një total prej 250 orësh. Praktikrat pedagogjike zhvillohen në institucionet më të mira publike të arsimit parauniversitar nën drejtimin e lektorëve përgjegjës të caktuar nga Përgjegjësi i Departamentit të Shkencave Sociale dhe të Edukimit. Gjatë praktikës profesionale, Lektorët përgjegjës janë gjithnjë të pranishëm.</p> <p><i>Por, praktikrat pedagogjike edhe në vitin e parë edhe në vitin e dytë, mbeten për tu rirregulluar dhe mbështetur nga sistemi i mentorëve, sistem i cili, teorikisht dhe konkretisht njihej shumë mirë nga stafi, por që nuk është funksional aktualisht. Kjo e prek cilësinë e programit referuar aspektit praktik.</i></p> <p><i>(Ref. – Rregullore UST, Kreu II, Neni 68, 69, 70, 71)</i></p> <p><i>(Ref. plani mesimor i prgramit te studimit master profesional - mesuesi ne ed e shendetsor ne ap)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Në rastet kur trajnimet janë të kërkuara FSHL – ja është përfshirë në projekte që fokusohen në profilin e Mësuesisë, për të qenë të denjë në ofrimin e trajnimeve profesionale për mësuesit e arsimit parauniversitar si dhe për studentët e diplomuar. Nga takimi me Dekanin e FSHL dhe stafin akademik konfirmuan se ky Fakultet është një nga partnerët e projektit <i>TEAVET 2017-2020</i> për “Zhvillimin e aftësive të mësuesit për një sistem gjithëpërfshirës të edukimit dhe aftësimit profesional në Shqipëri”. Ky projekt konsiston në zhvillimin e ekspertizës akademike përmes ngritjes së qendrave të specializuara në universitetet shqiptare dhe ofrimit të programeve të kualifikimit standard të një kualiteti të lartë në fushën e zhvillimit të kompetencave profesionale të mësuesve në Shqipëri gjatë gjithë jetës. Në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes është ngritur Qendra për Trajnimin e Vazhdueshëm të mësuesve.</p> <p><i>(Ref. Informacion zyrtar nga Drejtoria e Koordinimit,</i></p>

	<i>Marrëdhëniet me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI)</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Në mënyrë periodike njësjia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.	Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit që ofron programin e studimit në analizën vjetore të tij, bashkërendon veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore të stafit akademik, të realizur edhe nga marrëveshjet e bashkëpunimeve me IAL kombëtare dhe ndërkombëtare në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të këtij programi studimi.  <i>(Ref. – Model Analize Vjetore Departamenti të Shkencave Sociale dhe Edukimit)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi II.1 Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Nga shqyrtimi i dokumentacionit konfirmohet që programi i studimit Master Profesional në “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” është me kohëzgjatje 2 vite akademik, 120 ECTS, në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Grumbullimit dhe të transferimit të krediteve. Referuar kurikulës programi është organizuar në përmbajtje të tij nga:  Disiplina të formimit bazë ( <b>9 kredite</b> ); Disiplina të formimit karakterizues ( <b>47 kredite</b> ); Disiplina të formimit ndërdisiplinor dhe integruese ( <b>40 kredite</b> ); Disiplina plotësuese ( <b>13 kredite</b> ); Detyrime Përmbyllëse ( <b>11 kredite</b> ); Elementët përbërës të këtij program studimi janë: leksionet,



	<p>seminaret, ushtrimet dhe praktikat mësimore.</p> <p><i>(Ref. – Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”);</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Referuar nenit 6 të rregullores së programit, programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” synon t’u sigurojë studentëve:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- formimin e duhur si mësues të EF e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar;</li> <li>- të ndihmojë në formimin e specialistëve të aftë dhe me kompetenca profesionale për të ofruar shërbime për të tretët dhe konsulenca në fushën e EF, Sporteve, shëndetit dhe Veprimtarisë Fizike;</li> <li>- përgatitjen e mësuesit me vlera etike e profesionale që kanë një kuptim të qartë për institucionin shkollor dhe vendin që zë në shoqërinë e sotme;</li> </ul> <p>Dokumenti më i rëndësishëm që vlerëson këtë kriter është plani mësimor i këtij programi studimi. Programi në fjalë, vjen i sofitikuar dhe garanton cilësinë e diplomës, por, brenda mundësive që ofron ligji dhe liria e kopetencës në departament.</p> <p><i>GVJ sygjeron të shikohet pasurimi me një cikël leksionesh mbi kurrikulën zyrtare në sistemin parauniversitar.</i></p> <p><i>(Ref. – Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” Neni 6);</i></p> <p><i>(Ref. Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” përmbush synimin kryesor të dhënies së njohurive bashkëkohore në fushën e EF e Shëndetësor, përmes tipologjisë së komponentëve mësimor (lëndët karakterizuese dhe ndërdisiplinore), të cilat i pajisin studentët me njohuri të të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës së studimit.</p> <p><i>(Ref.– Plani Mësimor i Programit të Studimit)</i></p>
<p><b>Kriteri 4</b> Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve</p>	<p>Mbështetur në shqyrtimin e relacionit shpjegues dhe planit mësimor, konfirmojmë se, programi i studimit Master Profesional përmban lëndë dhe module të caktuara të cilat i japin mundësi studentëve të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca profesionale për të qënë mësues të aftë të menaxhojnë, organizojnë si dhe koordinues të procesit të</p>

komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	mësimdhënies dhe mësimnxënies. <i>(Ref.– Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i> <i>(Ref– Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i>
<b>Kriteri 5</b> Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.	GVJ konstaton se ky programi studimi është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.80/2015 (neni75). Programi ofrohet me 120 ECTS, me kohëzgjatje normale 2 vite akademike dhe me dy semestra.  Referuar shqyrtimit të Planit Mësimor konfirmojm se programi përmban:  592 orë leksion; 262 orë seminare; 274 orë ushtrime; 250 orë praktikë profesionale;  Programi në fjalë mbështetet edhe me infrastrukturë fizike për tu përmbushur.  <i>(Ref-Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” Neni 14;</i> <i>(Ref-Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP);</i>
<b>Kriteri 6</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Programi i këtij masteri është organizuar konform përcaktimit në shtojcën 1 të VKM nr 41 datë 24.01.2018. Referuar nenit 14 të rregullores së programit të studimit lëndët/modulet janë të organizuara në:  - Disiplina të formimit bazë <b>9 kredite;</b> - Disiplina të formimit karakterizues <b>47kredite ;</b> - Disiplina të formimit ndërdisiplinor dhe integruese <b>40 kredite;</b> - Disiplina plotësuese <b>13 kredite;</b> - Detyrime Përmbyllëse (Punim Diplome/ Provim Formimi) <b>11 kredite;</b>  Ngarkesa normale është 60 kredite në vit, e ndarë në 30 kredite për semestër.  <i>(Ref.– Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” Neni 14)</i>
<b>Kriteri 7</b> Programet e studimit parashikojnë	Pas shqyrtimit të planit mësimor u konstatua se praktika profesionale ka 10 kredite me një angazhim prej 250 orësh për

ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	studentin e organizuar në 2 (dy) module: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Praktika Pedagogjike në Edukim Fizik, me 6 kredite dhe 150 orë mësimore;</li> <li>- Praktika Pedagogjike në Edukim Shendetësor, me 4 kredite dhe 100 orë mësimore;</li> </ul> <i>(Ref-Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”);</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Njësia kryesore që është Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, i përmbush të gjitha detyrimet ligjore për vlerësimin për akreditim. Gjithashtu, edhe njësia bazë që është Departamenti i Shkencave Sociale dhe të Edukimit, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Ajo bashkëpunon ngushtë me strukturat në nivel fakulteti të cilat hartojnë politika për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë.  <i>(Ref. – Vendim Dekanati Nr. 52, dt. 01.10.2019, mbi miratimin e grupeve të vlerësimit të brendshëm të programeve të studimit në FSHL)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.	FSHL drejtohet nga Dekani dhe Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit nga përgjegjësi i tij, të cilët kryejnë funksionet e përcaktuar me ligj. Pas shqyrtimit të RVB dhe dokumentacionit të paraqitur konfirmojmë se Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit përmbush detyrimet ligjore për këtë program studimi lidhur me organizimin dhe strukturën akademike duke përcaktuar mënyrën e organizimit, stafin mësimor dhe atë ndihmësmësimor. Njësia bazë mundëson edhe monitorimin dhe vlerësimin e programit të studimit si në aspektin mësimor dhe atë të kërkimit shkencor. Ky monitorim është i paraqitur në dokumentacionin e analizës

	<p>vjetore të punës të bashkëlidhur në dokumentacionin e depozituar.</p> <p>FSHL-ja është e përbërë nga tre departamente konkretisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dep i Sportit, i cili ka në përbërjen e tij <b>20 PAE</b> nga ku 16 me tituj/grada;</li> <li>2. Dep i Shkencave Sociale dhe Edukimit, i cili ka në përbërjen e tij <b>13 PAE</b> nga ku 11 me tituj/grada;</li> <li>3. Dep i Mjeksisë Sportive, i cili ka në përbërjen e tij <b>8 PAE</b> nga ku 7 me tituj/grada;</li> </ol> <p><i>(Ref. 2.2.2.2 – Vendim Senati Nr. 2, dt. 10.01.2019 mbi Konfirmimin e Strukturës Organizative dhe Analitike sipas Vendimit Nr. 40, dt.12.11.2018 dhe numrin e personelit për vitin 2019);</i></p> <p><i>(Ref- Appendix Tabela 1);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.</p>	<p>Stafi akademik i programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” sigurohet nga departamenti përgjegjës që e ofron këtë program si dhe nga bashkëpunime me 2 (dy) njësitë e tjera bazë të FSHL. Gjatë shqyrtimit të DVV u konstatua se përbërja e Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2017-2018, (10 PAE / 3PAK)</b>, nga këta me grada/tituj shkencore <b>10 / 2;</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019, (11 PAE/ 0PAK)</b>, nga këta të gjithë me grada/tituj shkencorë;</p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020, (13 PAE / 0PAK)</b> nga këta me grada/tituj shkencore <b>11;</b></p> <p>Raporti personel akademik efektiv/student në nivel njësie kryesore për programin studimit, 1:6 (41 PAE / 315 studente).</p> <p><i>(Ref. Appendix Tabela 7)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e</p>	<p>Ky program studimi, përvec lëndës së Praktikës Pedagogjike në Edukim Fizik dhe Edukim Shëndetësor në të cilin angazhohet staf akademik, ofron një numër të konsiderueshëm orësh ushtrime (274 orë) ku stafi ndihmës akademik angazhohet për realizimin e tyre. Gjithësej angazhohen 5</p>

praktikave mësimore, laboratorike e klinike.	(pesë) staf ndihmës akademik. <i>(Ref. – Plani Mësimor i Programit të Studimit “Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i>								
<b>Kriteri 6.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	GVJ pas takimit që pati me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit që ofron këtë program studimi si dhe mbështetur në Vendimin e Dekanati Nr. 55, dt. 09. 10. 2019, mbi “Përcaktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit në FSHL”, u informua se Koordinatori i programit mbulohet nga Përgjegjësi i departamentit i cili koordinon dhe mbikqyr ecurinë dhe zhvillimin e programit.  <i>(Ref. – Vendim Dekanati Nr. 55, dt. 09. 10. 2019 mbi “Përcaktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit në FSHL)</i>								
<b>Kriteri 7.</b> Koordinator i programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesi i njësisë përgjegjëse dhe dokumenton çdo informacion që lidhet me programin e studimit.	Konfirmuam edhe nga takimet e zhvilluara në institucion se Koordinator i programit ndjek me prioritet zhvillimin e orëve mësimore, raporton periodikisht në Dekanat, për problematikat e hasura gjatë zhvillimit të programit të studimit. Koordinator i programit të studimit ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikës profesionale, mban kontakte të vazhdueshme me stafin akademik si dhe me studentët e programit të studimit  <i>(Ref– Vendim Dekanati Nr. 55, dt. 09. 10. 2019 mbi “Përcaktimin e Koordinatorëve të Programeve të Studimit në FSHL)</i>								
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Niveli i përmbushjes</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

### Standardi II.3

**Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e	Sikundërse referohet në RVB dhe u vërtetua dhe gjatë takimeve në institucion, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit është njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, e cila disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e

<p>programeve të studimeve.</p>	<p>programit të studimit. Ajo propozon strukturën dhe ndryshimet në planin mësimor, kurrikulën dhe stafin e përfshirë. Përgjegjësi i Departamentit është titullari që i propozon drejtuesve rishikimin e programit nëse është i nevojshëm. Dokumentacioni përmban rregulloret e organizimit të programit të studimit, Planin mësimor, Syllabuset e lëndëve dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore në stafin akademik të përfshirë. I gjithë dokumentacioni i lidhur me programin gjendet në departament dhe një pjesë e tyre dhe e publikuar në faqen e internetit të njësisë bazë dhe e afishuar në stendat e fakultetit. Dokumentacioni i paraqitur dhe RVB shprehen se njësia bazë përmbush detyrimet lidhur me personelin akademik dhe kualifikim e tij.</p> <p><i>(Ref.– Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”;</i>  <i>-Apendix Tabela 9</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.</p>	<p>Referuar planit mësimor programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi të cilat vlerësohen me ECTS, të dhëna që detajohen në planin mësimor te programit të studimit.</p> <p><i>(Ref.– Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”;</i>  <i>(Ref– VKM 41, dt. 25.01.2018 për Elementët e Programeve të Studimit të ofruara nga IAL)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.</p>	<p>Programi i studimit Mp në “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” është i organizuar me 120 kredite dhe i shtrirë në 2 (dy) vite akademike, 4 (katër) semestra. Secili vit ka 60 kredite. Programi i studimit konfirmojmë se është i organizuar në lëndë/modul sipas përcaktimeve ligjore në fuqi dhe të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendas dhe evropian.</p> <p><i>(Ref– Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”;</i>)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Nga shqyrtimi i planit mësimor dhe kurrikulës konfirmojnë se përmbajnë të gjithë informacionin e nevojshëm të përcaktuar sipas ligjit lidhur me: emërtimet e lëndëve/moduleve, shoqëruar me orët në leksion, seminar, ushtrime si dhe totali i tyre në orë mësimore në auditor, ku secili zë, ka vlerësimin me kredite përkatëse. Rregullat e ndjekjes së programit të studimit janë të parashikuara në Rregulloren e Programit të Studimit, Rregulloren e UST. Me</p>

	<p>mënyrat e vlerësimit të çdo lënde (provimet dhe mënyra e realizimit të tij, vlerësimi i vazhduar) studentët njihen në fillim të vitit prej pedagogëve të lëndëve/moduleve përkatëse si edhe përmes sekretarisë mësimore. Dokumentacioni lidhur me këtë kriter vlerësohet i plotë dhe i mjaftueshëm për studentin. Ky fakt është konfirmuar edhe prej studentëve të takuar, të cilët kanë vlerësuar pozitivisht këtë pjesë të njohjes së programit të ofruar nga institucioni. Vlerësimi i studentëve bazohet në vlerësimin e vazhduar dhe atë në provim si teorik ashtu dhe praktik në lëndë specifike. Për vlerësimin e dijeve përdoret sistemi i vlerësimit me 100 pikë, rezultati i të cilit detyrimisht kthehet në notë.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e Programit Neni 190);</i>  <i>(Ref– Plani Mësimor i Programit”);</i>  <i>(Ref-Apëndix Tabela 13);</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Programi i studimit u jep mundësi studentëve të aplikojnë për të ndjekur studimet në ciklin e dytë “Master Profesional” kandidatët që kanë përfunduar më sukses studimet në ciklin e parë “Bachelor” pranë FSHL apo IAL të tjera të ngjashme me të. Kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit, kryhen sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UST si dhe në numrin e kuotave të miratuar paraprakisht. Kriteret e pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të publikuara në faqen zyrtare të webit.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e UST, Kreu III, Neni 84, 85, 86, 87, 88)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Të gjitha programet/syllabuset e lëndëve janë hartuar në përputhje me kërkesat ligjore për përmbajtjen dhe formatin e tyre, ato miratohen çdo vit, pas kalimit të procesit të rishikimit dhe miratohen nga titullari i njësisë bazë dhe Dekani i FSHL. Pas shqyrtimit të syllabuseve, GVJ konfirmon se lëndët/modulet përkatëse të programit të studimit, janë të formatuara tërësisht në përputhje me VKM 41, dt. 25.01.2018. Në cdo syllabus janë të parashikuar specifikat e lëndës, rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat mësimore me cëshjet dhe nëncëshjet dhe sasinë e orëve për cdo temë, format e kontrollit të dijeve, frekuentimi i lëndës, si dhe literatura bazike dhe e rekomanduar. Gjithashu në syllabus të lëndës/modulit specifikohen me detaje përshkrimi dhe objektivi i modulit, rezultatet e të nxënit, detyrimet e studentit dhe vlerësimi i tyre, si dhe parashtrimi për cdo javë edhe orë të seminarëve</p>

	dhe ushtrimeve, duke specifikuar edhe metodologjinë e mësimdhënies. <i>(Ref.- VKM 41, dt. 25.01.2018;</i> <i>(Ref Apendix Tabela 14)</i>			
<b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Nga diskutimi me stafin akademik të këtij programi studimi, si dhe bazuar në RVB, përmirësimi dhe modifikimi i kurrikulës ndodh çdo vit nga lektorët e lëndëve/moduleve përkatëse, kryesisht duke futur koncepte dhe njohuri mbi praktika të reja e novatore. Gjithashtu stafi akademik ka konfirmuar se ndryshimet në syllabus dhe programe të çdo lënde diskutohen për të shmangur përsëritjet e informacionit në lëndë të ndryshme. Programet gjenden të arkivuara në Departamentin përgjegjës, Dekanatin e FSHL si dhe në Zyrën e Kurrikulës.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi II.4

**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.	Programi është në përputhje të plotë me nenin 75, pika 6 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë. Në bazë të kësaj pike përcaktohet se programet master profesional organizohen me 60 ose me 120 kredite dhe kohëzgjatja e tyre është një vit ose dy vite akademike.  Ky program studimi është organizuar në 120 kredite, 2 (dy) vite akademik dhe 4 (katër) semestra në përputhje me bazën ligjore në fuqi.  <i>(Ref.- LAL 80/2015, Neni 83, pika 2)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive	Organizimi i programit është realizuar që të ketë një balancim midis formimit teorik dhe atij praktik. Emërtimi i programit është në përputhje me fushat e studimit të cilat mbulon programi. Struktura e studimeve, përmbajtja akademike e



<p>dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>lëndëve dhe moduleve, realizimi i praktikave profesionale mundësojnë thellim të njohurive të studentëve për të formuar një student kompetent në fushën e Edukimit Fizik, Sportit dhe Shëndetit. Ky program studimi u siguron mundësi punësimi studentëve si mësues të edukimit fizik dhe shëndetësor në arsimin parauniversitar, si trajner, punonjës në shoqata sportive etj. Programi në fjalë, me diplomën që lëshon ofron mundësi jo vetëm si mësues brenda dhe jashtë sistemit, por dhe si trajner, punjës në shoqata sportive.</p> <p><i>(Ref.– Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Programi ka një shpërndarje të studiuar të ngarkesës që realizohet në 4 semestra, 2 vite akademike, dhe cdo lëndë vlerësohet me kreditin përkatës. Lëndët/modulet përmbajnë përshkrimin dhe objektivat sipas specifikave të secilës prej tyre, me synim përfllimin e njohurive të duhura nga ana e studentit. Në programet dhe syllabuset e lëndëve/moduleve përshkruhen rezultatet e të nxënit, të cilat janë specifike për cdo lëndë/modul, me synim formimin e studentëve si mësues të aftë në profesionin e tyre.</p> <p><i>(Ref.– Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p> <p><i>(Ref– Programet dhe Syllabyset)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teoripraktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Mbështetur në RVB si dhe në diskutimin me studentët konfirmojmë se struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teorik - praktikë është tërësisht në përputhje me profilin e programit të studimit. Lëndët metodologjike – teorike si dhe ato me natyrë sportive dhe mjekësore, praktika pedagogjike, seminarët dhe ushtrimet, si dhe detyrimet përmblylëse janë të shpërndara në mënyrë të ekuilibruar për të mos sjellë mbingarkesë tek studentët. Struktura e këtij programi studimi është në përputhje me programe të përafërta të universiteteve të tjera ndërkombërate si motra.</p> <p><i>(Ref.– Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë</p>	<p>Ndarja sipas veprimtarive formuese si dhe raporti midis formimit teorik, (që realizohet me lëndët bazë, karakterizuese e ndërsiplinore) është i drejtë në raport me lëndët praktike. Konkretisht Praktika Pedagogjike me 250 orë nënkupton</p>

<p>arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>finalizimin teoriko-praktik të njohurive të fituara në lëndët e ndryshme mësimore, veçanërisht atyre formuese profesionale gjatë zhvillimit të programit. Realizimi i Praktikës Pedagogjike, përgatit studentët e diplomuar të punojnë si mësues të Edukimit Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar. Vizita në institucion, diskutimi me stafin akademik, konfirmojnë mundësinë dhe lehtësimin e transferimit të studentëve në/nga programe të tjera studimi.</p> <p><i>(Ref.– Model Program e Syllabus i Praktikës Profesionale)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Nga takimi me përgjegjësin e departamentit dhe stafin akademik konfirmohet se lektorët e lëndëve/moduleve, përditësojnë në mënyrë të vazhdueshme programet e lëndëve duke u bazuar në literaturën bashkëkohore (si literaturë e detyruar dhe ndihmëse) të viteve të fundit si dhe bazuar në fondin e literaturës që disponon biblioteka e UST. Nga takimi me stafin akademik konfirmuam se cdo vit ata bëjnë kërkesa për të pasuruar fondin e librave sipas fushave përkatëse.</p> <p><i>(Ref. <a href="http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/">http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim të dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Përfitimi i dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara nga ky program studimi garantohet më së miri nga përmbajtja e tij. Ky program studimi garanton një formim profesional të studentit dhe zhvillim të kompetencave të synuara si: formimin e mësuesit kompetent në fushën e kurrikulës e praktikën në klasë, mësues me aftësi profesionale që të planifikojë, shpërndajë e të vlerësojë me efikasitet kurrikulën si dhe me aftësi të mira komunikimi.</p> <p><i>(Ref.– Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Struktura e programit të studimit përfshin disiplinat e formimit bazë, karakterizuese, ndërdisiplinor dhe detyrimet përmbajtëse të cilat pajisin studentët me njohuri, aftësi e dije kompetente në fushën e EF e Shëndetësor, gjithashtu përmbajtja dhe funksionimi i këtij programi studimi konsiston në një mësimdhënie cilësore, profesionale, duke ndërthurur praktikën me teorinë në raport të drejtë. Ky kriter përmbushet plotësisht duke patur parasysh numrin e orëve dhe shtrirjen që ka lënda e praktikës pedagogjike në këtë program studimi.</p> <p><i>(Ref.– Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”;</i></p>

	<i>(Ref- Rregullore e Programit Master Profesional "Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP" Neni 7, 13, 14)</i>			
<b>Kriteri 9.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur si dhe në takimin me anëtarë të Qendrës së Karrierës dhe ALUMNI, u informuan mbi mundësitë e punësimit për studentët e diplomuar si në institucionet publike dhe jopublike të arsimit parauniversitar ashtu edhe në palestra fitnesi, administratën publike, shoqata, klube dhe organizata sportive.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi II.5

**Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.	Personeli akademik i kontraktuar për zhvillimin e programit të studimit zotëron grada dhe tituj të ndryshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi duke patur ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e lëndëve të caktuara.  GVJ konfirmon se pas shqyrtimit të të dhënave të paraqitura në dokumentin <i>(Ref Apendixit, tabelat 6 dhe 7)</i> , rezulton se numri dhe kualifikimi i stafit të angazhuar në këtë program studimi, në tre vite akademike është si më poshtë:  Për vitin akademik <b>2017-2018</b> janë angazhuar <b>29 pedagogë (26 PAE / 3PAK):</b> -11 Prof.Dr; - 5 Prof.Asoc; - 12 Dr; - 1 Msc;  Mbulimi i programit në përqindje është <b>90% PAE.</b>
<b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.	Për vitin akademik <b>2018-2019</b> janë angazhuar <b>38 pedagogë (37 PAE / 1 PAK):</b> - 9 Prof.Dr;

	<p>- 6 Prof.Asoc;  - 19 Dr;  - 4 Msc;</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>97% PAE</b>.</p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020</b> janë angazhuar <b>38 pedagogë (37 PAE / 1 PAK)</b>:</p> <p>-7 Prof.Dr;  - 7 Prof.Asoc;  - 19 Dr;  - 5 Msc;</p> <p>Mbulimi i programit në përqindje është <b>97% PAE</b>.</p> <p><i>(Ref. Apendix Tabela 6, 7, 12.1, 12.2, 12.3)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.</p>	<p>GVJ pas takimit me Koordinatorin Përgjegjës së programit të studimit konfirmon se stafi akademik, kontribues në zbatimin e programit të studimit Master Profesional kanë nivelin e duhur të kualifikimit sipas fushave të përgjithshme dhe specifike akademike. Konkretisht lëndët me karakter sportive, psikosociale, teoriko-metodologjike si dhe ato me natyrë mjekësore mbulohen nga staf akademik i 3 njësive bazë, kontribuse në realizimin e programit të studimit. (Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit Departamentit të Sportit, Departamentit të Mjekësisë Sportive)</p> <p><i>(Ref. Apendix Tabela 12.1, 12.2, 12.3)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në institucion dhe takimet e bëra me Përgjegjësien e departamentit si dhe stafin akademik rezulton se në dispozicion të praktikës pedagogjike vihen pedagogë të kualifikuar. UST – ja për realizimin e praktikave profesionale në institucionet arsimore parauniversitare publike, bashkëpunon me Drejtorinë Arsimore të Tiranës – sot Zyra Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës. Progresi i punës së studentit monitorohet nga institucioni pritës dhe pedagogu përkatës. Në fund studenti paraqet një relacion dhe prezanton detyrat e kryera. Lektorët me tituj akademik dhe grada shkencore angazhohen në udhëheqjen e studentëve në realizimin e temave të diplomës. Gjithashtu konstatohet se nuk ka mbingarkesë të pedagogëve në udhëheqjen e temave, pasi të drejtën për të përmbyllur studimet më të mëdha të diplomës e kanë vetëm studentët të cilët vitin e parë të studimeve e kanë</p>

	<p>mbyllur me mesatare mbi noten 8.</p> <p>(Ref.– Rregullore UST, Kreu II, Neni 63, 64, 68, 69, 70, 71);</p> <p>(Ref– Model Marrëveshje Bashkëpunimi Për Praktikën Profesionale);</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjate vizitës në institucion, GVJ ka konfirmuar numrin e personelit ndihmës mësimor, i cili përbëhet nga 5 vetë, kryesisht përgjegjës për laboratorët dhe terrenet sportive. Personeli ndihmës ndihmon kryesisht për zhvillimin e orëve ushtrimore dhe procesin e kërkimit shkencor për realizimin e temave kërkimore të studentëve.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi II.6**

**Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunitorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Nga shqyrtimi i RVB si dhe takimit me Dekanin e Fakultetit, konfirmojnë se përmirësimi dhe përmbajtja e programit të studimit realizohet nëpërmjet njohjes me ndryshimet e kurrikulave të arsimit parauniversitar, bashkëpunimit me Zyrën Arsimore Vendore të Qytetit të Tiranës në përditësimin e informacionit që ka të bëjë me nivelin profesional të mësuesve të EF si dhe bashkëpunimit me federatat sportive në drejtim të kualifikimit të vazhduar të trajnerëve të rinj. Këto bashkëpunime janë reflektuar në riorganizimin dhe përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit me qëllim përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës.</p> <p>(Ref. – Plani Strategjik FSHL, pika 5)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimit të programit të studimit, edhe studentët dhe</p>	<p>Nga takimi me Përgjegjës të Departamentit dhe anëtarët e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, u identifikua se institucioni angazhohet për përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit duke reflektuar mbi sygjerimet e dhëna nga strukturat drejtuese të institucionit, studentët dhe stafi</p>

<p>strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>akademik. Referuar mendimeve, opinioneve të marra drejtëpërsëdrejti ose tërthorazi nga studentët dhe stafi akademik, njësia përgjegjëse e programit të studimit reflekton në kufinj të ligjore ndryshimet në programin e studimit.</p> <p><i>(Ref. 1.1.2.1 – Plani Strategjik FSHL, pika 5)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.</p>	<p>Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar, kontakte që realizohen nëpërmjet Qendrës së Karrierës (ALUMNI). Qendra e Karrierës dhe Alumni shprehet se duhen kërkuar rrugë dhe mënyra të tjera që mund të sigurojnë informacion më të plotë për studentët e diplomuar në këtë program studimi për një periudhë disa vjeçare. Mënyra e kontaktit realizohet përmes emailit, kontakteve që kjo Qender ka me Drejtorinë Arsimore Tiranë si dhe me studentët të cilët tërheqin dokumentacionin lidhur me studimet e kryera.</p> <p><i>(Ref.– Informacion zyrtar nga Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhëniet me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, ALUMNI)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.</p>	<p>Institucioni bashkëpunon me MASR, IZHA, KOKSH, Federata të ndryshme sportive etj, për të organizuar programe të posaçme (trajnimet e mësuesve, trajnerëve, menaxherëve dhe administratorëve sportive) në përputhje me kërkesat dhe nevojat specifike lokale të vendit. Nga takimi me Dekanin dhe Përgjegjësin e departamentit u informuam se së fundmi FSHL ka akredituar module trajnimi për mësuesit e arsimit parauniversitar si dhe për të gjithë studentët të cilët kanë përfunduar studimet në programin Master Profesional, module të regjistruara në portalin trajnime.gov.al.</p>			
<p><b>Shkalla e përbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përbushjes së standardeve të fushës II</b></p>	<p>Nuk përbushet</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

**III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT**

**Standardi III.1**

**Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	<p>Nga takimi me studentët e programit të studimit, stafin akademik si dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit, konfirmojmë se institucioni ka hartuar manual udhëzues për përdorimin e palestrave jashtë procesit mësimor, laboratorëve, rregjistrimet dhe prenotimet e provimeve nga studentët, <i>por nuk ka një udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave inovative të mësimdhënies.</i> Përdorimi i metodave të ndryshme të mësimdhënies paraqitet edhe në syllabuset e lëndës/modulit e cila realizohet nga Lektori i lëndës/modulit.</p> <p><i>(Ref. – Manual i Studentit)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.	<p>GVJ konfirmon se monitorimi dhe vlerësimi në mënyrë periodike të aftësive mësimdhënëse të stafit akademik si dhe performancës së personelit ndihmes akademik realizohet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Përgjegjësi i departamentit;</li><li>- Pyetësorëve me studentët të organizuar në nivel UST e reflektuar në analizën vjetore të punës së Departamentit dhe Fakultetit;</li></ul> <p>Të dhënat e vlerësimit vihen në dispozicion të Përgjegjësit të departamentit për tu diskutuar më pas me secilin staf akademik.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	<p>GVJ konfirmon se, Zyra e NJSBC –së bashkëpunon ngushtë më Fakultetin duke organizuar pyetësor me studentët e ciklit të studimit, mbi metodat e mësimdhënies, infrakstrukturën, tarifatat e shkollimit etj. NJSBC përpara sezonit të provimeve organizon këto pyetësor të cilët plotësohen on-line prej studentëve duke respektuar anonimatën e tyre dhe duke respektuar normën etike të një pyetësori. Gjithashtu konfirmojmë se NJSBC organizon takime me fokus grup, me studentët e këtij programi studimi. Kjo njësi ka konfirmuar grumbullimin e informacionit të vlefshëm prej studentëve lidhur me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor në tërësi.</p> <p><i>(Ref. 3.3.1.3 – Raport i Fokus Grupeve të Studentëve, NJSBC)</i></p>

	<i>Maj 2019)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Nga takimi me Dekanin dhe anëtarët e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë u informuam se, rezultatet e vlerësimeve të kryera lidhur me cilësinë dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor pasi përpunohen nga NJSBC, u vihen në dispozicion strukturave drejtuese të institucionit si burim për vlerësimin dhe përmirësimin e punës në vitin e ardhshëm akademik. Rezultatet nga Raportet përfshihen në Analizën Vjetore të strukturave drejtuese të institucionit, ku ftohen të marrin pjesë personeli akademik, ndihmës akademik, administrata dhe studentët.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e NJSBC, Neni 7)</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Nxitja e stafit akademik për përmirësimin e vazhdueshëm të procesit të mësimdhënies nëpërmjet evidentimit të praktikave më të mira, konfirmohet të jetë realizuar përmes organizimit të takimeve me stafin akademik dhe studentët e programit të studimit. Fakulteti shqyrton me kujdes raportet e përfunduara përmes mekanizmave vlerësues nga NJSBC dhe mer masa duke bërë këshillime individuale me personelin akademik në rast se evidentohen problematika për mësimdhënien.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e NJSBC, Neni 1)</i></p> <p><i>Analizë e Departamentit përgjegjës.</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	<p>GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit konstatoi se elementët e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me modelin e syllabusit të aprovuar me VKM Nr. 41, përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, mësimet praktike, detyrat e kursit, esetë) dhe se vemëndje e veçantë i kushtohet orëve të praktikave mësimore dhe pedagogjike me qëllim rritjen e aftësive praktike të studentëve.</p>



	<p>Bazuar në planin mësimor shpërndarja e orëve në auditor sipas formave të mësimdhënies është:</p> <p>Leksione <b>592</b> orë;  Seminare <b>262</b> orë;  Ushtrime/laboratorë <b>274</b> orë;  Praktikë profesionale <b>250</b> orë;  Totali <b>1378</b> orë</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e UST, Neni 39;</i>  <i>(Ref– Rregullore e Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”, Neni 16)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t’i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>GVJ referuar dokumentacionit në dispozicion dhe vizitës në institucion konstaton se personeli akademik pranon dhe respekton tu përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Personeli akademik respekton individualitetet e studentëve duke reflektuar jo vetëm në komunikimin korrekt dhe të drejtpërdrejt, por edhe në procesin mësimor duke ofruar modele dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies si, punë me grupe, ese, detyra individuale, seminare etj.</p> <p><i>(Ref. – Rregullore e UST, Neni 29)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Konfirmojmë se institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke përmirësuar infrastrukturën e tij (laboratorët, terrenet sportive, pajisje elektronike) për t’iu përshtatur nevojave dhe rezultateve të të nxënit, objektivave formues dhe kërkesave të programit të studimit. Gjithashtu institucioni mbështet personelin e tij akademik duke marrë pjesë në programe shkëmbimi si ERASMUS+ u ofron mundësi mobiliteti drejt institucioneve bredna BE.</p> <p><i>(Ref.– Plani Strategjik FSHL, pika 2,5,6)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Referuar CV-ve të stafi akademik të administruara në paketën e dokumentacionit dorëzuar nga institucioni, konstatohet se i gjithë stafi akademik i përfshirë në mësimdhënie në programin e studimit ka formimin e duhur bazë dhe të avancuar për të qënë pjesë akademike e programit. Stafi është me tituj dhe grada shkencore nga të cilët 7 janë të kategorisë Prof., 7 të kategorisë Prof.Asoc., 19</p>

	<p>lektor me gradën Dr. dhe 4me Msc. (Ref. - Model Syllabuset e lëndëve të programit.) (Ref Apendiks, Tabela 4)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Institucioni ka në qëndër të vëmendjes përfshirjen e studentëve në përmirësimin e cilësisë së personelit akademik dhe të metodave të mësimdhënies. Pas marrjes së mendimeve, sugjerimeve, apo edhe vërejtjeve të ngritura nga studentët, përgjegjësit e departamenteve apo organet më të larta drejtuese bëjnë verifikimet e duhura dhe marrin masat e ndryshme përmirësuese. Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh dhe me pjesëmarrjen e studentëve në orët e leksioneve të cilat e kanë fakultative pjesëmarrjen, sikurse u referua nga studentët, pjesëmarrja e lartë është tregues interesi prej tyre.</p> <p>(Ref.– Raport i Fokus Grupeve të Studentëve, NJSBC Maj 2019</p>			
<p><b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.</p>	<p>Takimi me stafin akademik na konfirmoi se në programet dhe syllabuset e lëndëve/moduleve të programit të studimit zhvillohen orë seminari, bashkëbisedimi, prezantim të projektorëve me PPT, apo të formave interaktive të diskutimit për të shkëmbyer idetë dhe përvojat e tyre në varësi të temave mësimore.</p>			
<p><b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Në varësi të llojit të lëndës/ modulit dhe temave mësimore, lektori ndërthur metoda të ndryshme mësimdhënieje croskurrikulare e integruese, me qëllim afirmimin e individualitetit të çdo studenti.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi III.3

**Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të</p>	<p>Gjatë vizitës në Institucion GVJ, konstatoi se institucioni ka në funksion të zhvillimit të programit mësimor.</p>

<p>cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>infrastrukturën e nevojshme si: salla leksionesh, seminaresh, mjedise sportive (salla e lojrave me dore, e fitnesit, e gjimnastikës, sporteve të rënda, fusha futbollit e tenisi) në funksion të zhvillimit të procesit mësimor. Mjediset janë rikonstruktuar vitet e fundit dhe janë në gjendje shume të mirë. Auditorët mësimorë të vizituar kanë kapacitete të mjaftueshme deri në 180 studentë në salla leksionesh dhe 35-40 studentë në salla seminaresh. Ato janë të pajisur me sistem kondicionimi, me pajisje laptopë/kompjuter, video-projektorë, pajisje të bollshme sportive. Hapësira dhe ndriçimi garantojnë një proces mësimor optimal, teorik e praktik dhe me nivele të mira të mësimdhënies. Nga shqyrtimi i RVB, konfirmojmë se hapësira në dispozicion përmbush standardin e përcaktuar në m<sup>2</sup>/student. Departamenti përgjegjës për programin e studimit Master Profesional disponon infrastrukturën e nevojshme për mësimdhënie në disa godina të UST-së dhe lehtësisht të aksesueshme.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konfirmon se, Interneti free wireless mundësohej në të gjithë godinat e tij e cila krijonte lehtësi në zhvillimin e procesit mësimor. Laboratori i informatikës kishte të instaluar programin e përpunimit statistikor SPSS lehtësisht të aksesueshëm si nga studentët ashtu dhe nga stafi akademik. Studentët dhe personeli akademik përdorin për qëllimet e tyre Sistemin për Menaxhimin e Informacionit të Studentëve. Aksesit në këtë sistem realizohet përmes account-it personal të studentit dhe pedagogut në platformën elektronike ESSE3.</p> <p><i>(Ref.- Kontratë Shërbimi Interneti Keminet;</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacioni të vënë në dispozicion nga institucioni (syllabuset e lëndëve) si dhe takimi me stafin akademik të programit të studimit, konfirmon se çdo lëndë ka literaturën e sugjeruar bazë dhe ndihmëse. Literaturën bazë lektorët ua vënë në disponon studentëve në hard copy, ndërsa literatura e rekomanduar të 5 viteve të fundit studentët kanë mundësi ta studiojnë në Bibliotekë në mënyrë të pavarur, pasi literatura bazë dhe e rekomanduar disponohet në Bibliotekën e UST-së.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Nga vizita në Bibliotekën e institucionit vumë rë se, ajo disponon sipërfaqe të bollshme 260 m<sup>2</sup> vende leximi dhe pajisje të mjaftueshme kompjuterike, të cilat pritet të shtohen sërisht në ndihmë të lexuesve. Fondi i bibliotekës është i</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të</p>	<p>Nga vizita në Bibliotekën e institucionit vumë rë se, ajo disponon sipërfaqe të bollshme 260 m<sup>2</sup> vende leximi dhe pajisje të mjaftueshme kompjuterike, të cilat pritet të shtohen sërisht në ndihmë të lexuesve. Fondi i bibliotekës është i</p>

<p>programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>pasur me materiale të ndryshme si: libra, gazeta, revista, dizertacione, mikro-teza, atlase etj. Shfletimi i manualit të studentit konfirmon se biblioteka disponon 3500 kopje librash nga të cilat 1740 janë tituj në gjuhë të huaj dhe 440 tituj në gjuhën shqipe. Takimi me stafin e bibliotekës konfirmon se fondi i saj pasurohet edhe nga materiale që botojnë pedagogët e UST-së.</p> <p><i>(Ref. – Manual Studenti)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Infrastruktura e institucionit u mundëson lektorëve dhe studentëve të UST-së të kenë akses pa limit interneti dhe mundësi përdorimi të fondit të Bibliotekës për të lexuar dhe studiuar. Studentët dhe stafi akademik i Universitetit kanë mundësi të aksesojnë on-line dhe të përdorin platformën e-learning për të përfutur literaturën e nevojshme me fushëm e programit të studimit. GVJ vizitoi ambjentet e bibliotekës së institucionit dhe konfirmon se ambjentet e saj janë komode dhe të mjaftueshme.</p> <p><i>(Ref. <a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Konfirmojmë se pas vizitës në ambjentet e institucionit Departamenti Përgjegjës disponon infrastrukturën e nevojshme laboratorike për të siguruar mbarëvajtjen e procesit mësimor. Laboratorët përdoren nga stafi akademik dhe studentët për proces mësimor dhe kërkimor shkencor, për detyra kursi, etj. Gjithashtu janë vënë në dispozicion të studentëve edhe laboratoritë e biomekanikës, i anatomisë humane, fiziologjisë së ushtrimit, biokimisë dhe gjenetikës, laboratoritë e fizioterapisë etj.</p> <p><i>(Ref.– Shkresë Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit UST, Nr.Prot. 1584, dt. 06.11.2018 mbështetur në Shkresën e Rektoratit UST, Nr. Prot. 1533, dt. 30.10.2018 për Inventarin e Ndarjes së Laboratorëve)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>Institucioni është angazhuar në përdorimin e teknologjive të reja të informacionit për përmirësimin e mësimdhënies dhe kualifikimin e mëtijshëm të stafit nëpërmjet përdorimit të instrumenteve si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Biblioteka online, duke mundësuar leximin dhe studimin e literaturës online;</li> <li>- të përdorin platformë e-learning në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies efektive;</li> </ul> <p>GVJ konstaton se metodat ndihmojnë stafin akademik dhe</p>

	<p>studentët me forma të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënit.</p> <p>(Ref. <a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a>)</p>								
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion u njohëm me Sistemin e Menaxhimit ESS3 nga RASH, i cili është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve deri në përfundimin e plotë të programit të studimit. Qëllimi kryesor është vënia në funksionim e një sistemi informativ për të digjitalizuar punën dhe procedurat mësimdhënëse, procedurat administrative të sekretarive mësimore të universitetit që siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik dhe studentët.</p> <p>(Ref.– Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një ndryshim në Rregulloren e UST”, 50/1.</p> <p>(Ref– Manual Rregjistrimi në portal të UST, Studentë);</p> <p>(Ref– Manual për provimet dhe Librezën Studentore)</p>								
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.</p>	<p>Mbështetur në Rregulloren e UST, në takimin me stafin akademik dhe Drejtuesin e Departamentit konfirmojmë se procedura për përcaktimin e temave të diplomës fillon një muaj nga data e fillimit të vitit akademik. Lektorët paraqesin temat e diplomës sipas fushës përkatëse kërkimore shkencore për studentët, të cilat bëhen publike në stendat e institucionit. Temat e Diplomës të sugjeruara apo edhe të tjera zgjidhen nga studentët dhe miratohen nga Përgjegjësi i departamentit. Studentët konfirmuan se brënda muajit dhjetor përcaktohen studentët që do punojnë tema, temat e diplomës, udhëheqësit shkencor. Takimi me stafin akademik të programit konfirmoi për GVJ se studentët janë të përfshirë kryesisht në tema të fushës psikosocial, sportive dhe shëndetësor.</p> <p>(Ref. – Rregullore e UST, Neni 63, pika 3/a,b)</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përbushet</th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

#### Standardi III.4

**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konfirmon se, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila funksionon në nivelin e UST-së vlerëson në mënyrë të rregullt, 2 herë në vit, përmes përfshirjes së studentëve me anë të një pyetësoi dhe takimeve me fokusgrupe. Çdo fillim viti akademik, NJSBC përgatit një plan vjetor pune ku bashkërendon aktivitetin e saj me njësitë kryesore të UST si dhe me NJSBC e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes për të promovuar përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies nëpërmjet zbatimit të procedurave të aprovuara nga organet drejtuese në cdo vit akademik. Duhet theksuar se në përbërje të NJSBC janë përfshirë edhe studentë.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e NJSBC, UST;</i>  <i>(Ref– Vendim Dekanati Nr. 7, dt. 16.01.2017 mbi Krijimin e NJSBC në FSHL)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>Përcaktuar edhe nga Ligji i Arsimit të Lartë, Departamenti që ofronte programin e studimit ishte përgjegjës për gjithë cilësinë e procesit të mësimdhënies dhe të të nxëniet që ai ofronte. Gjatë vizitës në institucion, GVJ është informuar mbi procedurën e ndjekur nga Dekanati i FSHL dhe Departamenti përgjegjës i programit të studimit mbi shkallën e performancës të programit të studimit, përmes përfshirjes së studentëve me anë të një pyetësoi. Të dhënat e vlerësimit diskutohen më pas me secilin personel akademik si dhe në analizat vjetore ku bëhet vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Këto procedura synojnë rritjen e vetëdijes së personelit akademik dhe studentëve për cilësinë e programit të studimit që ofron.</p> <p><i>(Ref.– Statut i UST, Neni 21;</i>  <i>(Ref– Rregullore e UST, Neni 20, pika 4)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ pohon se gjatë takimeve me stafin akademik, si dhe referuar RVB, Institucioni ofron mbështetje ndaj metodave inovative në mësimdhënie. Në takim u përmendën një numër leksionesh të hapura nga pedagogë të njësisë bazë apo edhe të ftuar të cilat i përkasin si sferës psiko-sociale e asaj sportive dhe shëndetësore.</p> <p><i>(Ref.– Plani Strategjik FSHL, pika 3, 4)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në</p>	<p>Sikurse është pasqyruar dhe në RVB, kualifikimi i stafit akademik është realizuar përmes pjesëmarrjes në konferenca</p>

fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	shkencore, mobiliteteve me institucione homologe jashtë vendit dhe projekte të ndryshme kërkimore shkencore duke përfshirë këtu dhe studentë. Sa më sipër cituam, vërtetohet nëpërmjet pjesëmarrjes së stafit akademik dhe studentëve në konferencat ndërkombëtare të organizuara edhe nga vetë UST, konferenca të tjera ndërkombëtare jashtë vendit si dhe në listën e projekteve të miratuara nga institucioni. Nga takimet në institucion u informuam se, stafi akademik ka detyrim të implementojë metodat inovative të mësimdhënies në funksion të përmirësimit të procesit mësimor.			
<b>Kriteri 5.</b> Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	(Ref.– Vendim Senati Nr. 25, dt. 17.05.2019 mbi “Miratimin e Projekteve Kërkimore Shkencore”)			
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	Një ndër pikat e Planit strategjik të zhvillimit të UST-së është matja e treguesve të performancës së personelit akademik. Gjithashtu Njësia bazë që ofron programin e studimit ka përgjegjësinë ligjore dhe funksionale të stafit akademik për mbarëvajtjen e procesit mësimor. Detyrë funksionale e stafit akademik është arritja e objektivave më të larta në cilësinë e punës mësimore dhe shkencore. GVJ konfirmon se në kuadër të analizës vjetore të kryer çdo vit nga Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit për ecurinë e zbatimit të programit të studimit, kryhet vlerësimi i metodave të reja, nëse ka pasur, dhe stimulohet futja dhe përdorimi i tyre kur vlerësohen të efektshme. Nga takimi me stafin akademik rezulton se përfshirja e studentëve në detyra kursi është vlerësuar i efektshëm.			
<b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmësakademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	(Ref.– Plani Strategjik i Zhvillimit UST, pika 3.5) (Ref Analiza vjetore e Departamentit)			
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	UST ka funksionale një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione të ngjashme, KOKSH në zbatim të të cilave mundësohet mobiliteti i stafit akademik. Nga takimi me Zyrën e Marrëdhënieve më Jashtë u konfirmua se deri më tani mobiliteti ka qënë i frytshëm në aspektin e shkëmbimit të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Referohemi raporteve specifike me universitetin e Bukureshtit ku kishte reciprocitet efektiv.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

**Standardi III.5****Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konfirmojmë se, format bazë të kontrollit të dijeve janë provimi me shkrim dhe testimi praktik. Për vlerësimin e kontrollit të dijeve përdoret sistemi i vlerësimit me 100 pikë të cilit i korenspondon nota përkatëse. Format e kontrollit janë provimet e ndërmjetme dhe provimi përfundimtar. Në Rregulloren e UST e cila është publike në faqen zyrtare të saj dhe është lehtësisht e aksesueshme nga studentët, përcaktohen qartë periudhat e zhvillimit të provimeve. Nga takimi me studentët u konfirmua se ata informohen nëpërmjet sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit (ESSE3) mbi kriteret dhe procedurat e avancimit akademik (detyrat e kursit, punët laboratorike, detyrime të tjera). Sistemi garanton njoftimin e studentëve nëpërmjet e-mailit. Gjithashtu, pedagogët në faqet e tyre personale në internet apo dhe nëpërmjet kontakteve direkte japin informacion të hollësishëm për studentët për lëndët e tyre.</p> <p>Referuar dokumentit (<i>Ref Apendiks, Tabelat 15, 15/1, dhe 15/2</i>), format e kontrollit të njohurive janë si më poshtë:</p> <p><i>Për lëndët me mbi 50 orë mësimore:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 20%;</li><li>- Testimet gjatë vitit 40 %;</li><li>- Provimi përfundimtar 40%;</li></ul> <p><i>Për lëndët deri në 50 orë mësimore, dhe lëndët me ushtrime mësimore praktike:</i></p> <ul style="list-style-type: none"><li>- Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 20%;</li><li>- Testimet gjatë vitit 35 %;</li><li>- Provimi përfundimtar 45%;</li></ul> <p>(<i>Ref.– Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një ndryshim në Rregulloren e UST</i>”, Neni 51);</p> <p>(<i>Ref– Rregullore e Program Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP, Neni 24”</i>);</p> <p>(<i>Ref– Model Komisioni Provimesh në Sezonet Përkatëse.</i>)</p> <p>(<i>Ref Apendiks, Tabelat 15, 15/1, dhe 15/2</i>),</p>



<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Nga vizita në institucion në takimin me stafin akademik, dhe me studentët, praktika e njoftimit të detyrimeve të studentit, metodologjia e vlerësimit dhe përshkrimi i syllabusit të lëndës është detyrim i çdo pedagogu/titullari dhe përmbushet në fillim të procesit mësimor për atë lëndë që përgjithësisht realizohet në orën e parë të seminarit orientues. Studentët gjatë takimit konfirmuan se informohen përmes pedagogëve për detyrimet e tyre dhe mënyrën e operimit për çdo lëndë specifike. Ky kriter konstatohet që është përmbushur cilësisht në programin në fjalë.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore UST, Neni 61)</i> <i>(Ref–Apendix Tabela 14)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>Shqyrtimi i RVB, takimi me stafin akademik dhe studentët konfirmuan se vlerësimi i dijeve realizohet në forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Vlerësimi i vazhduar i njohurive të studentit (projektet, esetë, aktivizimi, etj që përmbajnë 20% e vlerësimit përfundimtar);</li> <li>- Vlerësimi i testeve të ndërmjetme (për lëndët me mbi 50 orë mësimore: testi i parë i ndërmjetëm përmban 20% të vlerësimit përfundimtar; testi i dytë i ndërmjetëm, përmban 20% të vlerësimit përfundimtar; për lëndët deri në 50 orë mësimore: testi i parë i ndërmjetëm përmban 35% të vlerësimit përfundimtar);</li> <li>- Vlerësimi i testimit përfundimtarë (për lëndët me mbi 50 orë mësimore përmban 40% të vlerësimit përfundimtar; për lëndët deri në 50 orë mësimore përmban 45% të vlerësimit përfundimtar);</li> <li>- Vlerësimi i studentit në raportet: 65% pjesa e testimit praktik, 35% pjesa e testimit teorik të lëndës);</li> </ul> <p>Mënyra e vlerësimit në testin final është me shkrim dhe me testim praktik për lëndët praktike. Pesha e vlerësimit përfundimtar e cila është e shprehur dhe në syllabus është tregues në një shkallë më të plotë i njohurive të fituara.</p> <p><i>(Ref. – Rregullore UST, Neni 61;</i> <i>(Ref-Apendix Tabela 15, 15/1, 15/2)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi III.6****Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.</p>	<p>Nga takimi me Përgjegjësën e departamenti, stafin akademik si dhe mbështetur në dokumentacionin e vënë në dispozicion, Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit organizon dhe menaxhon procesin e testimeve dhe vlerësimit të njohurive. Vlerësimi bëhet sipas sistemit European të vlerësimit me notë, kredit, dhe fjalë. Të drejtën për tu futur në provim e vlerëson pedagogu i lëndës pas përmbushjes së detyrimeve të lëndës gjatë procesit mësimor. Testimi i kryer në provimin përfundimtar të lëndës është testimi më shkrim dhe testimi praktik për lëndët specifike.</p> <p><i>(Ref. – Rregullore UST, Neni 61;</i> <i>(Ref. Apendix Tabela 15, 15/1, 15/2)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Institucioni nuk ofron sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. Në Institucion kontrolli i dijeve bëhet me testime me shkrim dhe praktik. Informimi lidhur me rezultatet e provimit jepen në sistemin ESSE3.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Departamenti Përgjegjëse i programit të studimit propozon komisionet e provimeve të cilat miratohen nga Dekani i FSHL. Komisioni përbëhet nga së paku 2 anëtarë të cilët marrin pjesë në provim dhe vlerësimin e studentit dhe kryesohet nga titullari i lëndës. Ky komision është përgjegjës për zhvillimin korrekt të provimit. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët nuk u reflektuan problematika lidhur me këtë kriter. Procedura e ngritjes dhe funksionimit të komisioneve të provimeve është e përcaktuar në rregulloren e institucionit.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore UST, Neni 54, pika 2);</i> <i>(Ref– Model Propozimi i Komisionit të Provimeve)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit u konstatua se njësia kryesore në bashkëpunim me departamentin përgjegjës si dhe personelin akademik marrin masa për organizimin dhe zhvillimin e provimeve sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UST. Departamenti përgjegjës merr masa për realizimin e procesit të sekretimit. Provimet me shkrim bëhen në fletë të sekretuara. Procesi i sekretimit kryhet nga</p>

mjete survejimi.	personeli ndihmës mësimor. <i>(Ref.– Rregullore UST, Neni 54)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	GVJ konfirmon se vlerësimi i njohurive dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente për studentët në mënyrë që të sigurohet transparenca e vlerësimit si dhe për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Në rastin e provimit përfundimtar, komisioni pasi ka hedhur në sistemin ESSE 3 rezultatet dhe studentët janë njohur me vlerësimin, kanë të drejtë ta ankimojnë atë ose të takohen me lektorin përgjegjës për të parë testimin. Afati i ankimit është i përcaktuar në Rregulloren e UST.  <i>(Ref.– Rregullore e UST, Neni 61, pika 10);</i> <i>(Ref– Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një ndryshim në Rregulloren e UST”, 50/1, pika2);</i>
<b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Rregullorja e UST në nenin 61, pika 11 e tij përcakton veprimet e ndaluara, të cilat pengojnë mbarëvajtjen e provimit, të cilat shoqërohen me penaltete. GVJ ka konstatuar se lidhur me plagjiaturën, momentalisht ajo parandalohet përmes komunikimit pedagog / student, pasi ende nuk ka një program vlerësues për të përcaktuar plagjiaturën. Kopjimi, komunikimi me studentë të tjerë ndëshkohet me përjashtim nga provimi dhe me vlerësim negativ.  <i>(Ref.– Rregullore e UST, Neni 61, pika 11)</i>
<b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rregullorja e UST në nenin 61, pika 7, 8, 9 e tij përcaktojnë se rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë. Kjo gjë u vërtetua edhe në takimin me studeentët të cilët na konfirmuan se rezultatet e kontrollit të dijeve të tyre dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve.  <i>(Ref.– Rregullore e UST, Neni 61, pika 7, 8, 9)</i>
<b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t’u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me stafin dhe studentët u konfirmua se njohja me procesin e vlerësimit kryhet si detyrim pasi studenti merr informacion përmes platformës ESSE3. Në rast të gjykimit për vlerësim jo të saktë, studenti ka 48 orë kohë për të paraqitur kërkesën për rishikim të vlerësimit sipas procedurave të përcaktuara në Rregulloren e UST. Pas kalimit të këtij afati firmoset pasqyra e rezultateve nga komisioni i provimit dhe dorëzohet në sekretarinë mësimore. Gjatë takimit me studentët nuk u

	paraqit asnjë problematikë lidhur me zbatimin e këtij kriteri. (Ref.– Rregullore UST, Neni 57)			
<b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Rregullorja e UST përcakton qartë procedurat që ndiqen në rastet kur studentët ankimojnë vlerësimin e njohurive të fituara. Ky informacion u konfirmua edhe në takimin me studentët, të cilët pohuan se pasi kanë mbaruar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, sipas rregullores së institucionit, studenti duhet të hartojë një ankesë me shkrim në lidhje me vlerësimin (nëse ka), dhe e paraqet tek shefi i departamentit. Më tej ngrihet komisioni ad-hoc për verifikimin, i cili vendos për dhënien e një vlerësimi përfundimtar. Nuk patëm asnjë indikacion që studentët në program kishin ankimuar rreth një problemi të caktuar. (Ref.– Rregullore UST, Neni 57)			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.7</b>	
<b>Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Referuar Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor” e konfirmojmë se: objektivat dhe metodologjia si dhe instrumente e vlerësimit përgjatë këtij programi, e synojnë dhe e përmbushin garantimin e një studenti me profilin kulturor dhe profesional. Fokusi kryesor është përgatitja dhe formimi i mësuesit të EF e Shëndetësor me njohuri, aftësi, kompetenca profesionale për të zbatuar dhe vlerësuar kurrikulën në fushën e EF e Shëndetësor.  (Ref.– Relacion shpjegues për miratim të riorganizimit të programit të ciklit të dytë të studimeve Master, “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”);  (Ref.– Rregullore e Programit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP” Neni 6, 13, 14);
<b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në	Shqyrtimi i Planit mësimor konfirmon se Programi i studimit zhvillon aftësi në fushën e mësimdhënies, shëndetit, humane si dhe të teknologjive të reja në fushën e edukimit fizik dhe

<p>fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>ato sociale. Zhvillimin e aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit dhe gjuhë të huaj e përmban Programi i ciklit të Parë të studimeve “Bachelor”. Programi në fjalë, nuk i është kthyer formimit në gjuhë të huaj as formimit në teknologji referuar faktit që është i mbyllur në bachelor.</p> <p><i>(Ref.- Plani Mësimor i Programit të Studimit Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion takimit me stafin akademik, GVJ pohon se në përfundim të lëndës, stafi akademik bën vlerësimin e nivelit të kompetencave të fituara sipas syllabusit. Njësia organizon rishikimin periodik të programit të studimit bazuar në nivelin e përvetësimit të kompetencave në përfundim të lëndëve, të cilat lektorët e lëndëve e evidentojnë në përfundim të zhvillimit të tyre.</p> <p>Programi në fjalë ka paraparë përthyerjen e cdo moduli edhe në kopetencën/at respektive, gjë që e rrit cilësinë dhe e potencon përmbushjen e programit</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik dhe studentët konfirmohet se, në përfundim të çdo lënde/moduli, lektori në orën e fundit të seminarit bën një përmbledhje të tematikave mësimore të zhvilluara gjatë procesit mësimor ku studenti duhet të fokusohet për provimin përfundimtar. Pedagogu mund të realizojë orë shtesë, nëse kanë rezultuar elementë të vështirë për gjatë semestrit. Në këtë mënyrë studentët orientohen më mirë për tu përgatitur për testimin përfundimtar.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konfirmon nga takimi me stafin akademik, se organizimi i seminareve të hapura njoftohet nga lektorët përkatës duke publikuar në ambiente të dukshme të UST-së, temën që do të prezantohet, ditën dhe orën e mbajtjes së leksionit teksa fton të gjithë studentët të marrin pjesë. Këto takime zhvillohen si aktivitete ekstrakurrikulare, të hapura për tu ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>Nga vizita në institucion GVJ konfirmon se institucioni disponon infrastrukturën dhe logjistikën e nevojshme për tu dhënë mundësinë studentëve të aplikojnë njohuritë e marra në disiplinat teorike në praktikë. Mësimdhënia bazuar në kompetenca në këtë program studimi realizohet përmes dhënies së detyrave të kursit dhe ese në lëndë dhe tematika të ndryshme, ku studenti duhet të punojë individualisht dhe reëflekton njohuritë e fituara, sipas specifikimeve të dhëna nga pedogogu i lëndës.</p>

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Takimi me studentët konfirmoi se metodologjia e mësimdhënies në këtë program studimi ndërthur metoda bashkëkohore me qëllim interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme. Lektori i lëndës/modulit është aktor bashkëveprues në diskutimet me studentët, duke krijuar kështu interaktivitet midis tyre. Ai/ajo vlerëson, klasifikon, specifikon punën individuale të studentëve duke ju referuar kopetencave profesionale që studenti/ja duhet të përmbushë. Studentët vlerësohen jo vetëm për performance individuale por, dhe atë të punës me grupe, duke marrë kështu edhe rolin e organizatorit të orës së mësimit po ashtu edhe atë të bashkëudhëtarit në këtë proces.</p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.</p>	<p>GVJ konfirmon plotësimin e këtij kriteri nga shqyrtimi i dokumenacionit si dhe nga takimi me stafin akademik dhe studentët, të cilët listuan disa konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si bashkëautor me pedagogët e programit të studimit duke mbështetur fort idetë inovative të tyre. Institucioni mbështet financiarisht punimet kërkimore shkencore të studentëve. Konfirmojmë pjesëmarrje të pedagogëve dhe bashkëpunime me studentët në konferencën rajonale në datat 5-6 dhjetor në mjediset e UST. Në konferencën shkencore ndërkombëtare të organizuar nga institucioni, studentët ftohen të marrin pjesë në seksionin dedikuar prezantimeve të studentëve pa asnjë detyrim financiar.</p> <p><i>(Ref.– Libër Abstrakt Konferenca UST, 2017)</i> <i>(Ref.– Aplikim Konference UST, 2019)</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, s tudime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.</p>	<p>Gjatë takimit me Dekanin dhe Përgjegjësin e Departamentit, GVJ u informua se, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione, të cilat garantojnë kryerjen e praktikave pedagogjike. Gjithashtu marrëveshjet e bashkëpunimit për momentin kanë mundësuar mobilitetin e stafit akademik dhe të studentëve të ciklit të parë të studimeve “Bachelor” dhe të ciklit të dytë të studimeve “Master Shkencor”. Strukturat drejtuese shpresojnë që, këto mobilitete së shpejti të përfshijnë edhe studentët e programit të studimit Master Profesional.</p> <p><i>(Ref.– Model Marrëveshje Bashkëpunimi për Praktikrat Profesionale)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

				<b>X</b>
--	--	--	--	----------

### Standardi III.8

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
<p><b>Kriteri 1.</b> Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfundimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Pas shqyrtimi të planit mësimor rezultojnë se programi i studimit përmban Praktikë Profesionale në Edukim Fizik, (150 orë mësimore), dhe Praktikën Profesionale në Edukim Shëndetësor (100 orë mësimore). Për realizimin e tyre UST ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Drejtorinë Arsimore të Qytetit të Tiranës – sot Zyra Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës pasi zhvillimi i praktikës duhet të realizohet në institucionet e arsimit parashkollor.</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p><i>Konstatuam nga bashkëbisedat me stafin dhe me studentët, se: gjatë praktikave mësimore në shkollë mungonte eksperiencia e mjaftueshme për sa i përket dimensionit të shëndetit, ndoshta pasi mësuesit e diplomuar më herët nuk e kanë mjaftueshëm të zhvilluar këtë dimension edukimi.</i></p> <p><i>(Ref.– Model Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës për Praktikën Profesionale)</i></p> <p><i>(Ref.– Plani Mësimor i Programit të Studimit “Master Profesional “Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP);</i></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Praktikë profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Referuar planit mësimor praktikat pedagogjike e zhvilluara gjatë programit të studimit, ekuivalentohen në kredite (10 ECTS), dhe dokumentohen pranë Departamentit përgjegjës duke e shoqëruar me mendimin e lektorit përgjegjës si dhe vlerësimin përkatës gjatë procesit.</p> <p><i>(RefApendiks. Tabela 9, 10)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### Standardi III.9

**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>GVJ konfirmon se, programi i studimit Master Profesional i përmbyll studimet në 2 (dy) mënyra, ose me Temë Diplome ose me Provim Përfundimtar Formimi sipas përcaktimeve në aktet nënligjore në fuqi dhe Rregullores së UST. Dekanati në bashkëpunim me Departamentin përgjegjës ndjek procedurë të posaçme për zhvillimin e Provimit Përfundimtar të Formimit dhe mbrojtjes së Temës së Diplomës. GVJ konfirmon se Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit i bën publike procedurat e zhvillimit të tyre si në stendën e Fakultetit ashtu dhe në faqen zyrtare të tij.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore UST, Neni 63;</i>  <i>(Ref.– Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një ndryshim në Rregulloren e UST”, Neni 62, 62/1.)</i></p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimi me drejtuesin e njësisë kryesore, GVJ konfirmon se Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit në bashkëpunim me personelin akademik realizojnë mbështetjen për studentët për mbrojtjen e diplomës/provimin përfundimtar të formimit duke dhënë udhëzimet e nevojshme. Nga takimi me Koordinatorin e programit të studimit, konfirmojmë se, materiali i nevojshëm se ku duhet të bazohen studentët për Provimit Përfundimtar të Formimit gjendet në faqen zyrtare të Fakultetit. Referuar Temave të Diplomës, Udhëheqësi Shkencor është në mbikqyrje të vazhdueshme dhe mbështetës për studentin deri në përfundimin dhe mbrojtjen me sukses të Temës së Diplomës.</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a></p> <p><i>(Ref.– Model Program të tematikave)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final, bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik GVJ u konfirmua se fondi i pyetjeve të Provimit Përfundimtar të Formimit bazohet në testimin e njohurive të dhëna gjatë 2 (dy) viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet referuar peshës specifike të secilës prej tyre. E gjithë procedura është e parashikuar në rregulloren e institucionit.</p> <p>Stafi akademik i përfshirë në këtë program studimi, paraqet</p>



	<p>në Departament programin e tematikave ku duhet të mbështeten studentët, si dhe fondin e pyetjeve përkatëse për Provimin Përfundimtar të Formimit. Mbrojtja e diplomave realizohet përpara komisionit të posaçëm me anëtarë të Departamentit. Ai miratohet nga Dekani.</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a></p> <p><i>(Ref.– Model Program të tematikave)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Konfirmojmë se procedurat e përcaktimit të temave të diplomës realizohen në zbatim të Rregullores së UST. Stafi Akademik çdo fillim viti paraqet në Departamentin përgjegjëse të programit të studimit temat e diplomës sipas fushës së tij/saj të studimit. Ata orientojnë studentët në përzgjedhjen e temës së diplomës me qëllim që të jenë sa më afër interesave dhe nevojave profesionale të tyre. E konfirmojmë se: Studentët janë të lirë të zgjedhin udhëheqësin shkencor që do të mbështesë me sugjerime për metodologjinë e kryerjes së punimit, çështje etike të temës, burimet e kërkimit, literaturën shkencore indikatorët për grumbullimin e të dhënave, si dhe gjetjeve individuale gjatë aplikimit në praktike në varësi të temës së zgjedhur. Institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme (laboratorike, teknologjike dhe akademike) për kryerjen e matjeve e testeve të nevojshme nga studentët, në varësi të fushës së studimit.</p> <p>GVJ konfirmon sa më lart nga takimi i zhvilluar me stafin akademik, studentët e programit të studimit si dhe vizitës në laboratorët e institucionit.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e UST, Neni 63, pika 3/a,b)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik GVJ u informua për procedurën e provimit të diplomës. Udhëheqësi Shkencor asiston studentin gjatë gjithë kohës sipas një plani pune të hartuar paraprakisht prej tij. Ai sugjeron dhe e orienton studentin me literaturën, instrumentin matës të studimit, përpunimin statistikor të të dhënave, interpretimin e tyre, si dhe shkrimin e temës së diplomës. Pasi sigurohet që punimi përmbush kriteret e cilësisë në drejtim të përmbajtjes dhe formës udhëheqësi miraton që punimi të prezantohet para komisionit.</p> <p><i>(Ref.– Rregullore e UST, Neni 63, pika 3)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe konfirmimit të marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe të dhënave të depozituara në</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së</p>	<p>Sipas dokumentacionit dhe konfirmimit të marrë gjatë vizitës në institucion, si dhe të dhënave të depozituara në</p>

<p>diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Sekretarinë mësimore konfirmohet se vlerësimi bëhet me sistem pikëzimi i cili kthehet në notë. Vlerësimi i punimit të diplomës merr parasysh cilësinë e punimit të shkruar dhe të lidhur, prezantimin prej studentit gjatë mbrojtjes si dhe përgjigjet dhe arsyetimet përgjatë pyetjeve të komisionit.</p> <p><i>(Ref.– Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një Ndryshim në Rregulloren e UST”, Neni 62)</i></p>			
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”, studenti pajiset me Diplomë dhe Suplementin përkatës bashkangjitur. Formatu dhe përmbajtja e diplomës dhe suplementit të diplomës janë hartuar në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p><i>(Ref.– Urdhër MASR Nr. 355, dt. 24.10.2019 për Rregjistrimin e Formës së Diplomës)</i></p> <p><i>(Ref.— Rregullore e UST, Neni 66, 67)</i></p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të programit të studimit Master Profesional “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar”, studenti pajiset me Diplomë dhe Suplementin përkatës bashkangjitur, ku janë të pasqyruar me detaje të dhënat mbi kualifikimin e arritur. Këto formate janë hartuar në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Nga takimi me përfaqësuesen e Zyrës së Kurrikulës, u informuam se studentët të cilët dëshirojnë të disponojnë një kopje të plotë të programit të studimit e përfitojnë atë sipas procedurave të përcaktuara nga institucioni</p> <p><i>(Ref– Rregullore e UST, Neni 66, 67)</i></p>			
<p><b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se në sekretarinë mësimore bëhej arkivimi, ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit të studentit për një periudhë të pacaktuar, konform politikave të institucionit. Ky informacion mund të tërhiqet prej studentit të interesuar bazuar në kërkesën e tyre me shkrim.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<b>X</b>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p>Në përmbushje</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>	<p>Përmbushet</p>
--	----------------------	-------------------	-------------------	-------------------

standardeve të fushës III				
				X

#### IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Institucioni në organikën e tij ka ngritur zyrën e Burimeve Njerëzore. Kjo Zyrë është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe me kontratë. Gjatë vizitës në këtë zyrë GVJ u njoh me procedurën e rekrutimit dhe dosjet e stafit akademik.</p> <p>Çdo dosje e personelit përmbante dokumentacionet bazë, si CV, Diploma e Universitetit, Titujt Akademik/Gradë Shkencore, Trajnime dhe kualifikime të ndryshme, listë të publikimeve dhe artikujve, Dëshmi të Gjuhëve të Huaja, etj. Dosjet e pedagogëve ruhen në departamentin përkatës.</p> <p><i>(Ref. – Tabelat e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore UST;</i> <i>(Ref. – Model Fletë Inventari të Dosjes së Personelit)</i></p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Gjatë vizitës në zyrën e burimeve njerëzore, GVJ konstatoi se rekrutimi i stafit kryhej mbështetur në legjislacionin në fuqi, Ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores së Rekrutimit të Personelit akademik. Institucioni ka hartuar dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik. Rekrutimi i personelit akademik me kohë të plotë bëhet me konkurim të hapur e transparent. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit ndjek të gjitha procedurat e plotësimit të strukturës me rekrutime të reja, që nga shpallja publike e vendit të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në website zyrtar të UST, bashkangjitur formularët e aplikimit, kujdeset për procedurën e vlerësimit të dosjeve, zhvillimin e konkursit, informacionin përfundimtar dhe vendimin e emërimit. Kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët propozohen nga Departamenti përgjegjës.</p>

	<p><i>(Ref. – Statut i UST, Kreu VII, Neni 33)</i></p> <p><i>(Ref. – Rregullore e UST, Neni 25)</i></p> <p><i>(Ref. – Relacion për procedurat e rekrutimit të personelit akademik)</i></p>			
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur dhe vizita në zyrën e burimeve njerëzore, rezulton se institucioni ka hartuar procedura dhe kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, siç përcaktohet ne Rregulloren e UST. Kjo rregullore përcakton standarde për mënyrën e rekrutimit të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs.</p> <p><i>(Ref.– Relacion për procedurat e rekrutimit të personelit akademik)</i></p> <p><i>(Ref– Rregullore e Universitetit, neni 25, pika1, 2)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4</b> Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Sipas takimit në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit, nevoja për rekrutim të personelit lind në Departament. Përgjegjësi i Departamentit përcjell këtë kërkesë tek Dekanin i Fakultetit i cili më pas e përcjell në Rektorat. Më pas kjo kërkesë paraqitet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit e cila bën shpalljen e vendit vakant në Buletinin e APP. Rregullorja e rekrutimit përcakton shpalljen dhe zbatimin e kritereve të përgjithshme dhe të veçanta për çdo pozicion. Kriteret e përgjithshme e të veçanta të rekrutimit përcaktohen nga njësia bazë, bazuar në nevojat e kësaj të fundit dhe miratohen nga Rektori. Sipas afateve kohore të deklaruara, kritereve të përgjithshme dhe kritereve specifike në përputhje me modulën apo lëndën për të cilën departamenti ka nevojë për staf të ri, bëhet shpallja e konkursit, duke bërë publike kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, komisionin përzgjedhës, ditën, orën, dhe vendin e dorëzimit të dokumenteve dhe/ose intervistës me gojë. Gjatë vizitës në institucion nuk konstatoam të ketë ankimime sa i përket procedurave të marjes në punë të stafit akademik, qoftë PAE qoftë PAK..</p> <p><i>(Ref.– Statut i UST, Kreu VII, Neni 33)</i></p> <p><i>(Ref– Rregullore e UST, Neni 25)</i></p> <p><i>(Ref– Relacion për procedurat e rekrutimit të personelit akademik)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>

				X
--	--	--	--	---

### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Nga bisedat e zhvilluara me drejtuesin e Fakultetit dhe të Departamentit, grupet kërkimore-mësimore dhe stafin akademik si dhe nga vlerësimi i dokumentacionit të paraqitur, rezultojnë se institucioni është i angazhuar në krijimin e një mjedisi mbështetës dhe mundësive të barabarta të personelit për kryerjen e detyrave. Të gjithë personelit u janë krijuar mundësi të barabarta për kualifikim shkencor dhe përfshirje në projekte kërkimore shkencore. Mjediset e punës, laboratorët, sallat e leksioneve dhe seminareve, biblioteka, janë lirish të aksesueshme nga personeli për kryerjen me profesionalizëm të detyrave respektive.</p> <p><i>(Ref. Apendix Tabela 16)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me GVB, Përgjegjësin e Departamentit por dhe me stafin akademik, rezultoi se kualifikimi i vazhdueshëm i stafit që mbulon këtë program studimi, ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet e këtij institucioni duke mundësuar çdo facilitet, mobilitet nga Institucioni në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me universitetet homologe brenda dhe jashtë vendit. Institucioni mundëson mbështetje financiare për pjesëmarrje në Konferenca Shkencore Ndërkombëtare brenda dhe jashtë vendit, projekteve shkencore e çdo veprimtari tjetër kërkimore shkencore sipas procedurave të përcaktuara paraprakisht dhe buxhetit të tij. Për sa më sipër, GVI konstaton se mbështetja institucionale për kualifikim e vazhdueshëm të personelit akademik është serioze.</p> <p><i>(Ref.– Vendim Senati Nr. 23, dt. 17.05.2019)</i></p> <p><i>(Ref– Vendim Senati Nr. 25, dt. 17.05.2019)</i></p> <p><i>(Ref– Vendim BA, Nr. 29, dt. 18.07.2019 mbi Miratimin e Financimit të Projekteve Kërkimore Shkencore)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të</p>	<p>Në këtë institucion përveç metodave standarde të mësimdhënies (leksione, seminare, detyra e projekte kurse, praktika profesionale, provime) janë adaptuar edhe disa</p>

<p>teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>metoda inovative të mësimdhënies si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- E-learning që përfshin të gjitha format e të mësuarit dhe të dhënies së mësimin, e cila zhvillohet me ndihmën e pajisjeve elektronike. Me këto metoda, materialet e shtypura zëvendësohen me versione elektronike si dokumente, materiale të bashkëngjitura, prezantime power-point, audio, video, teste, forume, animacione etj;</li> <li>- Biblioteka dixhitale e UST, e cila është një bazë të dhënash me tekste, artikuj, revista shkencor;</li> <li>- Sistemi ESSE3 është një sistem i integruar për menaxhimin e mësimdhënies dhe shërbimeve drejtuar studentëve deri në mbrojtjen e diplomës. Qëllimi kryesor është vënia në punë e një sistemi informativ për të digjitalizuar punën dhe procedurat mësimdhënëse, procedurat administrative të sekretarive mësimore të universitetit;</li> </ul> <p>Për sa më sipër, GVJ konstaton se metodat ndihmojnë stafet akademike dhe studentët me forma të qëndrueshme dhe të standardizuara të shpërndarjes së të nxënës.</p>
--	---

<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Theksojmë se stafi akademik është njëkohësisht i angazhuar edhe në programe të tjera studimi të ofruara nga institucioni dhe ngarkesa totale e stafit shkon nga 240 orë deri në 460 orë në vit (për personelin akademik me gradën “Doktor”). Një pjesë e stafi akademik është i ngarkuar në limite të orëve të pagueshme referuar udhëzimit në fuqi. Procedura e rekrutimeve për staf akademik përbën logjistikën e mjaftueshme në burime njerëzore, përzgjedhja e tyre sipas kriterëve të përcaktuara ligjore dhe ato specifike, janë tregues domethënës të angazhimit optimal të burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së objektivave të programit.</p> <p><i>(Ref-Apendiks, Tabela 4)</i></p>
---	---

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<b>X</b>

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>

<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Nga shqyritmi i dokumentacionit por edhe nga vizita në institucion ku GVJ kishte planifikuar edhe vëzhgimin e ambienteve në funksion të zhvillimit të programit të mësimi, të ambienteve në funksion të pedagogëve që mbulojnë këtë program studimi, konfirmojmë se Institucioni ofron infrastrukturë të mjaftueshme për të mundësuar një mësimdhënie cilësore për studentët e saj.</p> <p>Institucioni ka auditorë leksioni, auditorë për seminare, laboratorë informatike, sallë interneti, sallë për bibliotekë, mjedise për fotokopje, zyrë informacioni për studentët (të kompletuar me sistemin e kondicionimit, video-projektimi, tabela shkrimi, sallat janë të pajisura me pajisje moderne elektronike) mjedise sportive, shlodhëse si dhe kafeteri. Sallat e leksioneve janë të pajisur me PC dhe projektor për realizimin e leksioneve me poker point. Laboratori i IT, lingistikës dhe gjuhës së huaj janë pajisur secili me nga 35 poste studimi me PC.</p> <p>Institucioni, në pikëpamjen e infrastrukturës potencon përbushjen e objektivave të programit në fjalë.</p> <p><i>(Ref. Apendix Tabela 16)</i>  <i>(Ref- Tabela e inventarizimit te pronave)</i>  <i>(RefTabelë e Infrastrukturës së UST – së)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p> <p>Institucioni ka auditorë leksioni, auditorë për seminare, laboratorë informatike, sallë interneti, sallë për bibliotekë, mjedise për fotokopje, zyrë informacioni për studentët (të kompletuar me sistemin e kondicionimit, video-projektimi, tabela shkrimi, sallat janë të pajisura me pajisje moderne elektronike) mjedise sportive, shlodhëse si dhe kafeteri. Sallat e leksioneve janë të pajisur me PC dhe projektor për realizimin e leksioneve me poker point. Laboratori i IT, lingistikës dhe gjuhës së huaj janë pajisur secili me nga 35 poste studimi me PC.</p> <p>Institucioni, në pikëpamjen e infrastrukturës potencon përbushjen e objektivave të programit në fjalë.</p> <p><i>(Ref. Apendix Tabela 16)</i>  <i>(Ref- Tabela e inventarizimit te pronave)</i>  <i>(RefTabelë e Infrastrukturës së UST – së)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Vizita në institucion konfirmon një numër të konsiderueshëm laboratorësh një pjesë e të cilëve janë mundësuar nga bashkepunimi me projekte. Programi i studimit ka në dispozicion laboratorë si i: Biomekanikës, Izokinetik, Psikologjisë, Fiziologjisë, Biokimik dhe Gjenetik, Informatikës dhe Lingistikës, Vlerësimin Motorik dhe Kordinative, Anthopometrisë Humane, Laborator i Fizioterapisë I, II dhe Terapisë Sportive, Laborator i Vlerësimin Postural, Laborator i Traumatologjisë dhe Ndihmës së Parë, për zhvillim efikas të procesit mësimor si dhe punë kërkimore shkencore. Për veprimtari mësimore me karakter sportiv janë në dispozicion salla e Dancit, Aerobisë, Fitnessit si dhe salla e lojrave me dorë. Laboratorët sigurojnë kushtet mjedisore të përshtatshme dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e programit të studimit, vecanarisht atë që lidhet me dimensionin e shëndetit.</p> <p><i>(Ref. – Shkresë Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit UST, Nr.Prot. 1584, dt. 06.11.2018 mbështetur në Shkresën e Rektoratit UST, Nr. Prot. 1533, dt. 30.10.2018 për Inventarin</i></p>

	<i>e Ndarjes së Laboratorëve)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ëve të studimit që ofron.	GVJ pohon se Institucioni ka salla kompjuterësh të lidhur me internet të cilët janë dispozicion të stafit akademik dhe studentëve. Nga takimet me stafin akademik dhe studentët rezultoi përdorimi i programeve specifike profesionale në përputhje me natyrën e programit të studimit. Programet Profesionale (Programi Statistikor SPSS Version 20, si dhe Paketa Office, Exel, Ëord) janë të licensuara. Laboratori ka kapacitetet dhe pajisjet kompjuterike të mjaftueshme në shërbim të realizimit të nevojave të programit të studimit.  <i>(Ref.– Shkresë Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit UST, Nr.Prot. 1584, dt. 06.11.2018 mbështetur në Shkresën e Rektoratit UST, Nr. Prot. 1533, dt. 30.10.2018 për Inventarin e Ndarjes së Laboratorëve)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike	Dekani i fakultetit si dhe stafi akademik, gjatë takimit në institucion theksuan se, terrenet sportive janë një vlerë e shtuar e këtij institucioni. Nga shqyrtimi i dokumentacionit konfirmojmë se sipërfaqet e terreneve sportive ofrojnë mundësi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për realizimin e praktikave mësimore. GVJ u informua se UST ka marrëveshje bashkëpunimi me DAR/ZA e cila potencon kryerjen e praktikave pedagogjike në institucionet e arsimit parauniversitar.  <i>(Ref.– Tabelë e Infrastrukturës së UST – së)</i> <i>(Ref.– Model Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës për Praktikën Profesionale)</i> <i>(Ref– Vendim Rektorati Nr. 105, dt. 15.11.2016)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.4

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.**

#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve

Gjatë vizitës në UST, GVJ vizitoi dhe ambientet e Bibliotekës e cila ka një sipërfaqe, vende leximi si dhe pajisje



<p>bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>kompjuterike (të cilat pritet të shtohen) në ndihmë të lexuesve. Studentët shfrytëzojnë ambjentet e Bibliotekës sipas nevojave të tyre. Referuar të dhënave të paraqitura, biblioteka ka një fond të konsiderueshëm materialesh audiovizuale, Video-kaseta dhe DVD, libra në gjuhë të huaj dhe shqipe për fusha të ndryshme të shkencave sportive që shfrytëzohen nga studentët e programit të studimit. Biblioteka ka një hapësirë prej 258.4m<sup>2</sup> me 48 vende leximi. Gjatë ditës dhe mbasdite sipas kërkesave të studentëve qëndron punonjësja e bibliotekës e cila vëzhgon dhe kujdeset për bibliotekën.</p> <p>(Ref. <a href="http://ust.edu.al/informacion-mbi-bibliotekën/">http://ust.edu.al/informacion-mbi-bibliotekën/</a>)</p> <p>(Ref dok nr.3.3.1.1 – Manual i Studentit)</p> <p>(Ref dok nr 4.4.4.1 – Fletë Rregjistri në Bibliotekë)</p> <p>(Ref dok nr 4.4.4.1.1 – Kartela e Studentit, Bibliotekë)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga takimi me personelin e bibliotekës gjatë vizitës në institucion si dhe në dokumentacionin e paraqitur nga GVB, fondi i bibliotekës përmban materiale si: libra, revista, dizertacione, mikro-teza, materiale audio-vizuale, atlase etj. Në bibliotekë ndodhen aktualisht 3500 kopje nga këta 1740 në gjuhë të huaj dhe 440 në gjuhën shqipe si dhe vëllime periodike. Salla e bibliotekës shfrytëzohet nga studentet edhe për përgatitjen e detyrave dhe projekteve të kursit sipas programeve të studimit. Fondi i bibliotekës pasurohet vazhdimisht me literaturë sipas kërkesave të stafit akademik. Një ndihmesë japin dhe projektet e ndryshme me futjen e titujve të rinj të literaturës bashkëkohore. Në bibliotekë është instaluar programi KOHA, në kuadër të bashkëpunimeve me projekt të përbashkët ndër-institucional, me anë të të cilit është mundësuar Katalogu on-line dhe pa asnjë kosto për përdoruesit. Ky katalog aksesohet lehtësisht nga të interesuarit. Biblioteka është e pajisur me pajisje teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>(Ref. <a href="http://ust.edu.al/katalogu-online/">http://ust.edu.al/katalogu-online/</a>;</p> <p>(Ref- Model Formularë Dhurimi)</p> <p>(Ref- Hyrjet e Literaturës në Bibliotekë nga 2017 deri 2019</p> <p>(Ref- Manual i Studentit)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>(Ref. <a href="http://ust.edu.al/katalogu-online/">http://ust.edu.al/katalogu-online/</a>;</p> <p>(Ref- Model Formularë Dhurimi)</p> <p>(Ref- Hyrjet e Literaturës në Bibliotekë nga 2017 deri 2019</p> <p>(Ref- Manual i Studentit)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e</p>	<p>Drejtuesi i institucionit konfirmoi se, cdo vit akademik parashikohet fond buxhetor për pasurimin e bibliotekës mbështetur në kërkesat e paraqitura nga stafi akademik i UST. Nga takimi me punonjësit e bibliotekës konfirmojmë se,</p>

fondit ekzistues në mbështetje të programit.	burime të tjera nga të cilat pasurohet dhe përditësohet fondi i bibliotekës janë: dhurimi i materialeve të botuara nga stafi akademik, donatorë si, Ambasada Gjermane, Ambasada Franceze, Projekti Tempus, Projekti Tempus “Sport Science Curricula in Albania and the Bologna Process Tempus JEP Sept 2006 – Aug 2008”. <i>(Ref. – Manual i Studentit)</i> <i>(Ref. – Vendimi i BA Nr. 15 dt. 01.03.2019 “Për detajimin e te ardhurave”)</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj	Nga takimi me studentët e programit të studimit konfirmojmë se biblioteka është e hapur çdo ditë nga e Hëna në të Premte nga ora 07 <sup>30</sup> -15: <sup>30</sup> si për studentët ashtu edhe stafit akademik. Biblioteka ofron shërbimet dhe kapacitetin e saj pa pagesë e në mënyrë të barabartë për të gjithë studentët dhe stafin e regjistruar. <i>Ref. – Manual i Studentit</i> <i>Apendiks, Tabela 16</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

#### Standardi IV.5

**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore të institucionit GVJ u njoh me regjistrat e studentëve në format elektronik dhe formë shkresore. Rregjistri bazë kishte të dhënat mbi regjistrimin e studentëve, numrin e matrikullimit në zbatim të akteve nënligjore në fuqi, vlerësimet e marra gjatë ndjekjes së programit të studimit deri në diplomim. Rregjistri i notave mban të dhëna për vlerësimin e studentëve për cdo vit akademik. Gjithashtu, Sistemi i Menaxhimit të Studentëve ESSE3 në UST zbaton politika të ruajtjes së të dhënave dhe përpilimit të statistikave në lidhje me studentët nga ana e sekretarisë mësimore si dhe regjistrave hard-copy, ky proces bëhet në përputhje të plote me kodin etik.

	<i>(Ref.– RASH INFO)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	<p>Referuar RVB në bashkëpunim me Rrjetin Akademik Shqiptar (RASH), përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve ESSE3 realizohet ruajtja e të dhënave dhe përpilimi statistikor i tyre nga sekretaria mësimore si dhe regjistrave hard-copy. Gjithashtu ESSE3 administron informacion dhe aktivitetin e stafit akademik. Pjesa administrative, si pranimi dhe regjistrimi i studentëve, menaxhimi i studentëve në hyrje dhe në dalje, si dhe provimet janë detyrë e Degës së Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve. Informacioni ruhet në zbatim të plotë të Marrëveshjes së Konfidencialitetit.</p> <p>Nga vizita e bërë në Degën e Informacionit Studentor dhe Rregjistrimeve të UST konfirmojmë se, menaxhimi dhe administrimi i informacionit edhe në regjistrat hard-copy, lidhur me realizimin e programit të studimit është i plotë, i saktë dhe në përputhje me aktet nënligjore në fuqi.</p> <p><i>(Ref.– Marrëveshje Konfidencialiteti me RASH)</i></p> <p><i>(Ref <a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a>)</i></p>
<b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	<p>Sistemi i Menaxhimit ESS3 aksesohet lehtësisht nga i gjithë personeli akademik dhe studentët e regjistruar, dhe ofron të gjithë funksionalitetet e nevojshme. Ata mund të kryejnë çdo veprimtari të mundshme si, prenotim provimesh, rregjistrim në provime, printime të formularëve të ndryshëm etj. Përmes këtij sistemi lektori i lëndës/ modulit shkëmben informacione e nevojshëm me studentët e programit të studimit.</p> <p><i>(Ref.– Manual Rregjistrimi në portal të UST, Studentë;</i></p> <p><i>(Ref– Manual për provimet dhe Librezën Studentore</i></p> <p><i>(Ref <a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a>)</i></p>
<b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.	
<b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.	<p>GVJ konfirmon se, Sistemi i Menaxhimit të Studentëve ESSE3 garanton monitorimin në kohë reale të aktivitetit mësimor. Kjo i kontribuon shmangies së vonësave dhe rritjes së transparencës. Drejtuesit e institucionit mund të nxjerrin raportime e të dhëna për procesin mësimor dhe aktivitetin akademik.</p>
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e	<p>GVJ konstatoi se informacioni lidhur me programet e studimit, aktivitetet dhe njoftimet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të tij: <a href="http://www.ust.edu.al/">www.ust.edu.al/</a> dhe disponohen në dy gjuhë, shqipe dhe angleze. Gjithashtu të interesuarit</p>

internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe	<p>njihen edhe nëpërmjet formave të tjera të informimit sic janë njoftimet e vëna në stenda apo rrjete sociale brenda grupit të interesuar. Platforma e U-Transparencës është një tjetër hapësirë elektronike ku institucioni shfaq informacione dhe vendime të ndryshme qe mer.</p> <p>(Ref. <a href="https://ust.edu.al/">https://ust.edu.al/</a>)</p> <p>(Ref- Manual të Formave Elektronike të Informimit)</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Mbështetur në dokumentacionin e paraqitur rezulton se, institucioni harton raport financiar të kostove të programit të studimit Master Profesional. Përlllogaritja e kostos së programit të studimi, bazohet në shpërndarjen e ngarkesave mësimore të stafit akademik, shpenzimet për bazën materiale didaktike, shpenzime te tjera (energji, uje, etj) dhe amortizim vjetor etj. Ndryshimi i legjislacionit ka sjellë nevojën e rishikimit të tarifës së shkollimit, si rezultat i së cilës tarifa e shkollimit është ulur.</p> <p>(Ref- <i>Relacion mbi miratimin e tarifave të shkollimit, konkurimit dhe rregjistrimit për vitin akademik 2019 – 2020, dhe ndryshimin e tarifës së shkollimit;</i></p> <p>– <i>Vendim Senati Nr. 5 dt. 10.01.2019 mbi Miratimin e propozimit të tarifave për aplikim, konkurim, rregjistrim të fituesve, tarifave të shkollimit dy cikleve të studimit, UST.</i></p> <p>– <i>Vendim Bordi Administrimi Nr. 7, dt. 31.01.2019 mbi Miratimin e Detajimit Art 602.8 në UST.</i></p> <p>– <i>Plani i financimit për vitin akademik 2018 – 2019</i></p> <p><i>Apendix Tabela 18</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në	Nga takimi me Administratoren e UST GVJ konstatohet se Institucioni harton një plan financimi për të gjithë strukturën universitare. Buxheti i institucionit përmban disa

<p>shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtje e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>zëra: grantet nga pushteti qendror, për mësimdhënien, për kërkim dhe kontratat, fondet jopublike, shpenzime për projekte shkencore, të ardhurat, etj. Financimi i burimeve njerëzore, mirëmbajtja e aparaturave të teknologjisë, shpenzimet për bibliotekën (shtimin e pasurimin me literaturë të huaj), mbulohen nga financimi i ardhur në grand nga MASR dhe të ardhurat e krijuara nga çdo program studimi si dhe nga shërbimet me palët e treta, të cilat miratohen në Senat dhe Bord Administrimi. Pasqyrat financiare të paraqitura vërtetojnë se institucioni ka patur fonde të mjaftueshme për funksionimin e këtij programi studimi. Detajimi i grandit miratohet me Vendim të Bordit të Administrimit dhe Vendim Senati i cili përfshin materiale shërbimi, ngrohjeje etj, libra dhe publikime profesionale, pajisje laboratorike, shpenzime për honorare etj., në mbulim të kostos së programit të studimit, si dhe miratimin e të ardhurave për shpenzime operative, mjete audiovizuale, projekte shkencore, etj, të cilat u konfirmuan nga takimi me Administratoren e institucionit.</p> <p><i>(Ref.– Pasqyrat Financiare, 2018)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>Referuar RVB, konfirmohet se çdo vit institucioni i nënshtrohet auditimit nga MASR i cili paraqet aspektet më të rëndësishme financiare, si auditim mbi strukturën organizative dhe zbatimin e procedurave ligjore në llogaritjen dhe shpërndarjen e pagave, mbi zbatimin e ligjshmërisë për hartimin e buxhetit të shtetit, si dhe kryerja e veprimeve me thesarin, mbi prokurimin e fondeve publike, mbi organizimin dhe mbajtjen e kontabilitetit, mbi procedurat për përdorimin e fondeve për bursat, mbi krijimin dhe përdorimin e të ardhurave, si dhe auditim mbi ngarkesat e orëve mësimore mbi normën e ngarkesës. Në përfundim të auditimit vjen raporti i auditimit i cili shqyrtohet nga Bordi i Administrimit.</p> <p><i>(Ref.– Dërgim Raporti Auditimi nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, MASR, me Nr. Prot. 6040/3, dt. 31.08.2018)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, por edhe nga takimi me Administratoren e UST, Raporti i Veprimtarisë Mesimore, Shkencore dhe Financiare bëhet publik për studentët, stafin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ në një mbledhje të hapur të Senatit dhe të Bordit të Administrimit. Në Raportin Financiar të UST, specifikohen objektivat përkatëse si dhe realizimi i tyre. Administratorja e UST</p>

mbarëvajtjen normale të tij.	<p>konfirmon se nuk ka patur problem për të ndërhyrë për diversifikimin e financimit për këtë program studimi pasi të ardhurat e krijuara nga tarifat kanë qenë të mjaftueshme për funksionimin normal të këtij programi studimi.</p> <p><i>(Ref.- Statut i UST, Neni 11)</i></p> <p><i>(Ref- Rregullore e UST, Neni 15)</i></p> <p><i>(Ref- Vendim Bordi Administrimi Nr. 1, dt. 11.01.2019 mbi Miratimin e Objektivave Financiare të vitit 2019)</i></p> <p><i>(Ref- Vendim Senati Nr. 1 dt. 10.01.2019 "Për miratimin e objektivave për vitin 2019"</i></p> <p><i>(Ref- Raporti i Veprimtarisë Mesimore, Shkencore dhe Financiare, me Vendim Senati Nr. 45, dt. 24.12.2018 dhe Vendim Bordi Administrimi Nr. 36, dt. 24.12.2018.)</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Shqyrtimi i dokumentacioni dëshmon se, institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare gjatë procesit të zhvillimit të programit të studimit Master Profesional, si rezultat i të ardhurave nga Buxheti i Shtetit, tarifat e aplikimit dhe shkollimit, financime të ndryshme nga shërbimet me të tretë. Programi i studimit financohet kryesisht nga të ardhurat e krijuara nga programi respektiv i studimit. Gjatë viteve të fundit buxheti i UST ka qenë i mjaftueshëm dhe ka garantuar ecurinë dhe mbarvajtjen me sukses të programit të studimit.</p> <p><i>(Ref.- Pasqyrat Financiare, 2018)</i></p> <p><i>(Ref - Apendix Tabela 18)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

### Standardi V.1

**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e**

**dijeve dhe diplomimin në programin e studimit**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	<p>Referuar dokumentacionit GVJ konfirmon se institucioni procedon për pranimin e studentëve në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe rregullores e statutit të institucionit, rregullores së fakultetit dhe rregullores së programit të studimit. Pranimet ne programin e studimit, i referohen kritereve të propozuara nga Departamenti përgjegjës për programin e studimit të miratuara me vendim Senati, e cila kujdeset që të ndjekë të gjithë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse. Numri i studentëve bëhet referuar kuotave të pranimit (studentë për program të dytë studimi, transferime, të huaj, statusin e jetimit, romë dhe ballkano egjipjan si dhe studentë nga trojet shqiptare)</p> <p><i>(Ref.dok nr. 2.2.4.1 - Ligji Nr. 80/2015, Neni 83)</i></p> <p><i>(Ref.dok nr. 1.1.1.2 – Rregullorja e programit te studimit, Neni 10, 11, 12)</i></p> <p><i>(Ref.dok nr. 5.5.1.1 – Vendim Senatit Nr. 11, dt. 01.10.2019 “Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit per vitin akademik 2019-2020.”</i></p> <p><i>(Ref.dok nr. 5.5.1.1.1 – Vendim Senati Nr. 6, dt 19.01.2017 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2017-2018)</i></p>
<b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bashkëbisedës me strukturat respektive, konfirmojmë se procedurat e permbushjes së programit te studimit janë rigoroze, dhe se i garantojnë të drejta dhe detyrimet cdo student/je nga fillimi deri në përmbyllje. E gjithë procedura, të drejtat dhe detyrimet u bëhen të ditura studentëve që në fillim të programit të studimit. Studentët njohin në detaj dhe detyrimet përmbyllëse të programit Master Profesional në FSHL, të cilat janë të përcaktuara në zbatim të VKM nr. 41 si dhe me Vendim Senati kur është celur programi. Nuk konstatuam shkelje të procedurave nga bisedat me studentët.</p> <p><i>(Ref. Dok nr.2.2.3.6 – VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018, pika gj)</i></p> <p><i>(Ref. Dok nr 1.1.1.2 – Rregullorja e programit te studimit neni 13)</i></p> <p><i>(Ref. Dok nr 5.5.1.1.1 – Vendim Senati Nr. 6, dt 19.01.2017 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2017-2018)</i></p>

<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Referuar dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ konstatoi që, kriteret dhe procedurat përkatëse për ofrimin e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të jenë të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. Ato publikohen në faqen e web dhe afishohen në ambientet fizike. Procedura nis në fillim të çdo viti akademik, ku Departamenti i bashkëpunim me Dekanatin e FSHL organizon takim me studentet e rinj për t'i informuar rreth procedurës së vlerësimit të dijeve, për procedurat e diplomimit mbështetur në Rregulloren e UST. Stafi akademik respektivisht për çdo lëndë, në fillim të lëndës/modulit i informon studentët me procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive, kptencave, sipas elementëve përbërës të lëndës/modulit përkatës duke u bazuar në Rregulloren e UST dhe syllabin e lëndës/modulit.</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/udhezues">http://fshl.ust.edu.al/udhezues</a></p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/lista-e-aplikanteve-fitues-ne-programin-e-studimit-te-ciklit-te-dyte-master-profesional-mesuesi-ne-ef-dhe-shendetesor-ne-arsimin-parauniversitar-ne-fakultetin-e-shkencave-te-levizjes">http://fshl.ust.edu.al/lista-e-aplikanteve-fitues-ne-programin-e-studimit-te-ciklit-te-dyte-master-profesional-mesuesi-ne-ef-dhe-shendetesor-ne-arsimin-parauniversitar-ne-fakultetin-e-shkencave-te-levizjes</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit konfirmojmë se çdo fillim viti akademik, Institucioni publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Refruar vendimit të senatit institucioni ka përpiluar mënyrën e rekrutimit të studentëve për ciklin e dytë master profesional.</p> <p>Në këtë program studimi gëzojnë të drejtë të konkurrojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të gjithë kandidatët që kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve Bachelor pranë FSHL apo IAL të tjera të ngjashme me të;</li> <li>- Konkurimi bëhet referuar dosjes personale të paraqitur nga kandidati/tja në Sekretarinë Mësimore sipas afateve të shpallura në faqen zyrtare;</li> <li>- Kriteri bazë do të jetë ai i notës mesatare;</li> <li>- Të preferuar mbeten kandidatët që kanë kryer studimet në FSHL;</li> <li>- Kandidatët e tjerë potencohen nëse ka hapësirë bosh. Edhe kjo kategori konkuroese pranohet duke ju referuar rezultateve të nivelit Bachelor;</li> </ul> <p>Nuk konstatojmë se ka kriter tjetër përjashtues apo preferencial në pranimin për ndjekjen e programit në fjalë.</p>



	<i>(Ref. 5.5.1.1.1 – Vendim Senati Nr. 6, dt 19.01.2017 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2017-2018)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit	<p>Institucioni ka politikat e veta për të informuar publikun në fillim të programeve që shpall. Fillimisht publikon kriteret, për pranimin në programin në fjalë, Master Profesional në “Mësuesi në edukimin fizik dhe shëndetësor në arsimin parauniversitar”. Kontakton në mënyrë procedurale dhe zyrtare me shkollat e mesme, qoftë profesionale, qoftë të përgjithëshme, ju ofron atyre objektivat, qëllimin dhe formatin e diplomës respektive për të siguruar intresin e tyre. Këte e bën life ose në faqen zyrtare, si dhe në mjediset e institucinit. Fletëpalosja është një nga format që aplikon për informim të të interesuarve.</p> <p><i>(Ref.dok nr. 5.5.1.5 – Fletëpalosje FSHL;</i>  <i>(Ref.dok nr. 5.5.1.5.1 – Vendim Rektorati Nr.15, dt. 15.02.2019 mbi Organizimin e Ditëve të Informimit të Maturantëve)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.2</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	<p>Gjatë vizitës konfirmojmë se egzistojnë procedura të detajuara dhe të përshkruara në rregulloren e programit rreth: kriterëve të regjistrimit, konkurimit, pranimit, tarifimit, dhe gjithë procesit të shkollimit për gjatë dy viteve. Studentët janë të informuar në fillim dhe përgjatë shkollimit rreth cdo hapi institucional që do ndjekin në përmbushje të cdo disipline, praktikës pedagogjike, transferimit apo konvertimit të provimeve si dhe mbartjen e tyre në kohë. Egziston një informim në system për studentët dhe pedagogët që sinkronizon gjithë veprimtarinë reciproke akademike por dhe atë administrative që lidhet me sekretarinë.</p> <p>Transferimet nga një fakultet tek tjetri, provimet, diploma, proceset e diplomimit, cdo gjë është e miremenduar. Nuk konstatuam çështje që lidhen me mos menaxhim informimi të</p>

	<p>studentëve. Rreth aspekteve financiare të programit të studimit ku përfshihet menaxhimi i tarifave; bursat; institucioni informon studentet në kohë dhe në detaje. Gjithashtu, studentet informohen në kohe reale në posten individuale elektronike në sistemin ESSE3 per rezultatin e provimeve.</p> <p><i>(Ref. dok nr.1.1.1.1.1 – Rregullore UST, Neni 60, pika 5, 61)</i></p> <p><a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Gjatë vizitës kuptuam se Institucioni është i hapur të pranojë në konkurim dhe të rregjistrojë cdo student që ka rezultuar fitues në kriteret që ka vendosur institucioni në rregulloren e programit. Institucioni nuk përjashton mundësinë për asnjë student fitues pavarësisht se mund të ketë kryer studimet Bachelor jashtë vendit.</p> <p>Institucioni nuk aplikon procedurën e ekujalentimit.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë hulumtimit të strukturës së syllabuseve konstatohet lehtësisht se procesi i vlerësimit të dijeve është pjesë e strukturës në cdo syllabus. Lektor, hartuesi i syllabusit ka parashikuar jo vetëm instrumentat e vlerësimit por dhe indikatorët matës të arritjes. Stafi akademik, respektivisht përgjegjës i lëndës/ modulit në orën e parë të seminarit orientues njih studentët me kriteret e lëndës dhe vlerësimin e tyre. Studenti vlerësohet për pjesëmarrje në leksione, seminare, punime të ndryshme krijuese, ese, të cilat përbëjnë 20% të vlerësimit përfundimtar, testimi i ndërmjetëm 35% vlerësimit përfundimtar dhe provimi i sezonit të provimit përbën 45% të vlerësimit në total. Të gjitha këto janë të përcaktuara në Rregulloren e UST.</p> <p><i>(Ref. dok nr1.1.1.1.1 – Rregullore UST, Neni 54, 61)</i></p> <p><a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit konstatoam se institucioni informon rregullisht studentët me procedurat e punimit të diplomës/provimit përfundimtar. Ky proces bëhet verbal por dhe përmes faqes zyrtare. Njësia bazë në bashkëpunim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e temës së diplomës. Rregullorja për punimin e diplomës përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit. Departamenti brenda muajit nëntor publikon temat e ofruara nga pedagogët, ndërkohë që studentët janë të lirë zgjedhin nëse do të përfshihen në temë diplome apo provimin përmbyllës.</p>

	<p>(Ref. <a href="http://fshl.ust.edu.al/ep-content/uploads/2019/05/Provimi-Perfundimtar-MP-2019.pdf">http://fshl.ust.edu.al/ep-content/uploads/2019/05/Provimi-Perfundimtar-MP-2019.pdf</a>)</p> <p>(<a href="http://fshl.ust.edu.al/ep-content/uploads/2018/05/Kerkesa-dhe-Platforma-e-mikrotezave.pdf">http://fshl.ust.edu.al/ep-content/uploads/2018/05/Kerkesa-dhe-Platforma-e-mikrotezave.pdf</a>)</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ konfirmon se tri janë rrugët e informimit të studentëve rreth programit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njoftimet në faqen zyrtare;</li> <li>- Njoftimet e informacionet e vendosura në stendat e Fakultetit;</li> <li>- Publikimin e guidës të FSHL-së;</li> </ul> <p>Departamenti që mban përgjegjësi për programin në fjalë mban kontakte periodike me Drejtoritë Arsimore Rajonale, Zyrat Arsimore, Shkollat e Mesme, dhe ato Profesionale Sportive. Institucioni ka mjetet e veta për të lancuar profilin e spikatur të programit dhe mundësitë e punësimit duke shpjeguar dhe cilësinë e diplomës që ky program lëshon. Ditët e hapura, panairët e organizuara me maturantët kur ata po bëjnë zgjelljen e tyre rezultojnë të jenë efikase.</p> <p>(Ref.dok nr. 5.5.1.5 – Fletëpalosje FSHL)</p> <p>(Ref.dok nr. 5.5.2.5 – Guida e FSHL)</p> <p>(Ref.dok nr. 5.5.1.5.1 – Vendim Rektorati Nr.15, dt. 15.02.2019 mbi Organizimin e Ditë)</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

### Standardi V.3

**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet dhe mundësitë e punësimit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe bashkebisedave me studentët u informuam se ata marrin në kohën e duhur (fillim të studimeve), në mënyrë të hollësishme informacion rreth strukturës semestrale, shtrirjes, syllabuseve, mënyrës së zhvillimit të provimeve, indikatorët që vleresojnë cdo disiplinë. Kjo bëhet duke organizuar takime informuese</p>

	<p>periodike, në grup apo individualisht. Cdo informacion është i aksesueshëm në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p><i>(Ref. <a href="http://fshl.ust.edu.al/master-profesional/">http://fshl.ust.edu.al/master-profesional/</a>)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>GVJ nga vizita në institucion konstatoi se për programin e studimit “Master Profesional” në “Mësuesi në edukimin fizik dhe shëndetësor në arsimin parauniversitar” cdo student kishte informacionin e mjaftueshëm dhe të posaçëm për lëndët/modulet, format e vlerësimit, rrugët e ankimimit.</p> <p>Në llogarinë e tyre në sistemin ESSE3 studentët aksesojnë strukturën e cdo program studimi që ofrohet me elementët përbërës në lëndë e module dhe kreditet përkatëse. Cdo fillim semestri studentëve u vihet në dispozicion program/syllabusi i të gjitha lëndëve që do të zhvillohen ku janë të përcaktuara në mënyrë të detajuar ngarkesa, temat për cdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit literature etj. Nuk vecuam ndonjë udhëzues të posaçëm rreth kësaj procedure, por i referoheshin Rregullores së UST.</p> <p><i>(Ref. <a href="http://fshl.ust.edu.al/master-profesional/">http://fshl.ust.edu.al/master-profesional/</a>)</i>  <i>(Ref dok nr.2.2.4.3 – Model Syllabusi)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Nga takimi me studentët, konstatoam se ata në shumicën e rasteve ishin të punësuar, por jo në mësimdhënie, por në qendra sportive dhe rekreacioni. Gjithsesi studentët me të cilët bashkëbiseduam ishin mjaftueshëm të qartë rreth mundësisë për punësim në mbyllje të programit. Shumë prej tyre kishin ide të qarta rreth mundësisë dhe rëndësisë për punësim si mësues, dhe rreth peshës specifike që ofronte kjo lloj diplome. Studentët ishin të informuar rreth tregut të punës si nga institucioni, por dhe në rrugë individuale. Koordinator i programit kish organizuar takime informuese në grup dhe individuale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Ashtu sic e kemi theksuar dhe më lart në raport, institucioni ofronte të gjitha hapësirat logjistike, dhe gjithë mbështetjen përmbajtësore për zhvillimin e procesit mësimor në kushte optimale duke ju referuar specifikave të programit të studimit. Studentët kanë në dispozicion labororet si dhe ambientet sportive.</p> <p><i>(Ref. 3.3.1.1 – Manual i Studentit; Apendix Tabela 16, 17)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të</p>	<p>Gjatë vizitës konfirmojmë se kemi prekur një menaxhim që funksionon në sistem. Institucioni ofronte në mënyrë periodike dhe koherente informacion për stafin akademik,</p>

<p>menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>administratën dhe studentët për administrimin e të gjithë ciklit akademik si: regjistrimi në program/syllabus-et e kurseve, vlerësimet deri në diplomim, gjithashtu transferimet nga njëri universitet në tjetrin, menaxhimin e Karrierës së Studentit si dhe administrimin e provimeve dhe diplomimin, aspekte financiare, menaxhimi i tarifave, bursat, e tjer. Te dhenat studentore gjenden në sistemin ESSE3.</p> <p><i>(Ref. 3.3.3.9.1 – Manual rregjistrimi ne portal, Studentet)</i></p> <p><a href="https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë*, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit e konstatojmë se Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve dhe ecurinë e tyre gjatë programit dhe me tej. Institucioni e përmbush këtë detyrim përmes sekretarisë dhe Sistemit ESSE3 ku dokumentohet elektronikisht cdo e dhënë.</p> <p><i>(Ref. 1.1.1.1.1 – Rregullore UST, Neni 24, 24/1)</i></p> <p><i>9Ref Apendix Tabela 21, 21/1)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>Nga vizita ne Institucion GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumenta ku merret informacion statistikor vjetor për numrin e studentëve përmes sekretarisë mesimore dhe Sistemit të Menaxhimit të Studentëve ESSE3. Kjo paketë mundeson nje database te dhenash mbi studentet per ciklet studimi dhe gjini. Nuk vecuam raste të studentëve të larguar nga programi, apo shtyrje në kohë të studimeve.</p> <p>Nga të dhënat e deklaruara dhe të konfirmuara në sekretarinë mësimore rezultojnë të regjistruar për herë të parë sipas viteve akademike:</p> <p>2019 – 2020 <b>150 studentë;</b></p> <p>2018 – 2019 <b>159 studentë;</b></p>

	<p>2017 – 2018 <b>156 studentë;</b></p> <p>Nota mesatare në hurje varion nga <b>6.46</b> në 2017 në <b>6.67</b> në 2018.</p> <p><i>(Ref. 1.1.1.1.1 – Rregullore UST, Neni 24, 24/1)</i></p> <p><a href="https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në institucion GVJ konstaton se Sistemi ESSE 3 dokumenton një database të dhënash mbi studentët për cikël studimi në mënyrë të detajuar rreth ndjekjes së programit, provimeve, praktikave dhe cdo gjë që ndoll me secilin student. Cdo student ka dosjen e tij, ku përmban të gjitha të dhënat, që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim. Dega i Informimit Studentor dhe Regjistrimit është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave të studentit.</p> <p><i>(Ref. 1.1.1.1.1 – Rregullore UST, Neni 24, 24/1;</i></p> <p><i>(Ref dok nr.Apendix Tabela 21, 21/1)</i></p> <p><a href="https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Ë konfirmojmë që të dhënat e dokumentuara dhe të mirëmbajtura për cdo gjë që lidhet me programin menaxhohen në Sistemin ESSE 3, këto të dhëna janë të aksesueshme lehtësisht nga të intresuarit brenda programit dhe të verifikueshme nga personat e autorizuar. Gjithcka funksionon në frymen e ligjit dhe të rregullores së institucionit. Nuk konstatuam ankime që lidhen me këtë procedurë.</p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Ë konfirmojmë që Departamenti përgjegjës për programin cdo vit harton raportin me të dhëna specifike duke analizuar gjithë proceset që lidhen me mësimdhënjen, ndjekjen e studimeve, cilësinë, ecurinë dhe përmbushjen e objektivave semestrale e vjetore të programit shoqëruar dhe me detyra specifike për më tej. Një kopje e raportit të kësaj analize i përcillet dekanatit, për të hartuar një raport analitik në nivel njësie kryesore. Ky raport hsrben si bazë për hartimin e objektivave për vitin pasardhës.</p> <p><i>(Ref. 1.1.4.6 – Analizë Vjetore e Departamentit)</i></p> <p><i>(Ref dok nr.Apendix Tabela 21, 21/1)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

**Standardi V.5**

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.**

**Kriteret****Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.

Nga takimi me studentet konstatuam se institucioni parashikon anagzhimin e studentëve në organet drejtuese dhe vendimmarrëse të institucionit sic janë: Senati, Këshilli i etikës, përfaqësohen si anëtar me të drejta të plota në përgatitjen e RVB, me statusin e studentit që sjell mendimin e tyre për programin dhe ecurinë e tij.

*(Ref dok nr.5.5.5.1.3 – Vendim Senati Nr. 32, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e grupit te punes per hartimin e Rregullores se Etikes të UST)*

*(Ref dok nr.5.5.5.1.4 – Shkresë Rektorati Nr. Prot. 48, dt. 08.01.2019 për grupin e punës për përzgjedhjen e literatures huaj, përfaqësues nga UST)*

**Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.

E konfirmojmë se përfshirja e studentëve në vendimmarrje, këshillim, vlerësimin mbi procesin akademik, është konkrete, dhe lehtësisht e verifikueshme. Gjatë procesit per riorganizimin e masterit profesional, ne Senatin Akademik kanë qënë aktivë dy studentë. Përapra përfundimit të semestrit studentët bëjnë vlerësim të programit në bazë lënde, përmes pyetsorit që plotësojnë. Gjithashtu funksionojnë edhe focus-group-et, dhe intervistat gjysmë të strukturuar me grupe studentësh të programeve përkatëse. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente janë pjesë e diskutimeve në nivel institucioni, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjene masave për përmisim të vazhdueshëm.

*(Ref. 1.1.1.3 – Vendim Senati Nr. 37, dt. 10.11.2016 Për Veprimtarinë e FSHL mbi Riorganizimin e Programit të Studimit Master Profesional Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)*

**Kriteri 3.** Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe

Gjatë vizitës në institucion dhe bashkëbisedës konstatuam se Departamentet përgjegjëse i japin vëmëndjen e duhur ngarkesës mësimore të personelit akademik, duke evituar mbingarkesën dhe disbalancë me numrin e studentëve që ndjekin programin në fjalë të studimit. Ngarkesa mësimore e stafit akademik rezultojnë në përputhje me numrin e studentëve,

parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.	conform ligjit dhe rregullores së institucionit. Institucioni kujdeset mjaftueshëm për shpërndarjen e ngarkesës akademike të studentëve në programin e studimit dhe evitimin e procedurave burokratike.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.	Ashtu sic dhe e theksuam më lart, studentët janë mjaftueshëm të përfaqësuar në strukturat vendimarrëse. Kjo i ka mundësuar ata të kenë mjaftueshëm informim rreth asaj që programi përfaqëson si mund të mirëmbahet, si mund të përmirësohet brenda hapësirave ligjore. Gjatë procesit të riorganizimit të masterit kanë qënë të pranishëm dy student.  <i>(Ref. 1.1.1.3 – Vendim Senati Nr. 37, dt. 10.11.2016 Për Veprimtarinë e FSHL mbi Riorganizimin e Programit të Studimit Master Profesional Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Konstatuam se procesi i vlerësimit të studentit është i transparent, i paanshëm dhe profesional. Studenti gëzon të gjitha të drejtat të informohet dhe të të ankimohet për rezultatet/in. Ankimimi bëhet me shkrim përgjegjësit të departamentit brenda 48 orëve nga data e shpalljes së rezultatit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe ka detyrimin të ktheje përgjigje. Nëse e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, bëhet me dije Dekani, i cili brenda 48 orësh nga marrja dijeni ngre një komision ad-hoc i cili bën verifikimin. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose mund të marrë vendim për rrizhvimin të provimit.  <i>(Ref. 1.1.1.1 – Rregullore UST, Neni 57)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi V.6

**Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka	E dëshmojmë se institucioni ka ngritur njësinë e këshillimit



<p>procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.</p>	<p>dhe orientimit të studentëve. Ky proces kryhet në mënyrë të programuar. Studentët kanë informacion për vendin dhe orën e pritjes. Këtë informacion e marrin përmes faqes zyrtare të FSHL-se ku përditëson informacione të detajuara për studentët, stafin. Institucioni përdor për komunikimin e brendshëm e-mail zyrtare. Çdo anëtar i institucionit ka adresën zyrtare të e-mailit (...@ust.edu.al).</p> <p><i>(Ref dok nr.5.5.6.1 – Vendim Rektorati Nr. 107, date 15.11.2016 mbi krijimin e zyrës së këshillimit, informimit e orientimit të Fakulteteve UST)</i></p> <p><i>(Ref dok nr.5.5.6.1.1 – Orari i pritjes studenteve FSHL)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .</p>	<p>Sistemi ESSE-3, potencon cdo student të kontaktojë periodikisht me stafin akademik dhe administrativ për cdo çështje që lidhet me procesin mesimor, rezultatet e vleresimit, mungesat, vleresimin, praktikat profesionale, etj.</p> <p><a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Në institucion funksionon Zyra e Këshillimit dhe Informimit të Studentëve. Kjo njësi, njeh dhe ndihmon studentët të marrin informacion të detajuar rreth karrierës së tyre në mbarim të programit. Njësia për këshillimin e karrierës i kontakton studentët në mënyrë frekvente, të planifikuara apo kur studentët ndiejnë nevojën për saktësime specifike. Sidomos kjo zyre ndihmon studentët për identifikimin e hapësirave për të kryer praktikat profesionale, dhe ndermjetëson kontaktin referuar kontratave të institucionit. Zyra funksionon zyrtarisht për studentet nga dita e Hene dhe te Enjte, ne orarin 11.00 – 13.00.</p> <p><i>(Ref. 5.5.6.3 – Vendim Senati Nr. 41, dt. 31.10.2019 mbi Miratimin e Rregullores së Brendshme të Administratës i Ndryshuar; Rregullore e Administratës, Neni 5)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese</p>	<p>Nga bashkëbiseda me studentët, konfirmojmë se Njësia e Këshillimit dhe Karrierës ndihmon dhe orienton studentët jo vetëm gjatë përmbushjes së programit, por dhe pas diplomimit. Në parim dhe referuar rregullores së programit, Zyra duhet të disponojë të dhëna për vendin e punësimit e performancën e tyre. Por, referuar faktit që të diplomuarit në vitin akademik 2018 – 2019, janë brezi i parë i studentëve që përfunduan Masterin Profesional “Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor në AP”, institucioni, ende, nuk disponon database</p>

përkatëse	përfundimtare. <i>(Ref. 5.5.6.4 – Shkresë zyrtare, Administratori UST, Nr. Prot. 1670/9, dt. 10.10.2019, mbi punësimin e studentëve të UST)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

<b>Standardi VI.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Gjatë vizitës në institucion bashkëbiseduam me stafin që punon për Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Kjo zyrë, përmbush detyrat e saj referuar akteve ligjore e nënligjore dhe atyre rregullatore institucionale. Zyra, përmes instrumenteve kërkimorë, identifikon cilësinë dhe domosdoshmërinë e këtij programi në tregun e punës. Zyra është garante e cilësisë dhe zbatimit të vendimeve brenda institucionit. E konfirmojmë që stafi që zyrtarisht përmbush funksionimin e kësaj zyre ishte mjaftueshëm serioz dhe njëjtte thellesisht detyrat funksionale.  <i>(Ref dok nr.6.6.1.1.1 – Vendim Senati Nr. 16 dt 27.02.2018 për ngritjen e NJSBC në UST)</i>  <i>(Ref dok nr.3.3.1.4 – Rregullore e NJSBC, Neni 1)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm	NJSBC e ka nisur punën që me krijimin e institucionit fillimisht në formën e grupeve dhe komisioneve ad-hoc, dhe që në mars të 2018 në formën e një njësie të përhershme në srtukturën organizative të institucionit. NJSBC, jo vetëm ngre indikatorë për mbikqyrjen e ecurisë të programit, por dhe mban përgjegjësi për hartimin e pyetësorëve, anketave,

<p>të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>organizimin e “focus grup” dhe identifikon çështjet specifike ku mund dhe duhet të përdoret njëri apo tjetri indikator matës dhe vlerësues. Vecanarisht kjo njësi, fokusohet të vjelë informacion nga studentët sa i përket cilësisë së mësimdhënies, performancës së stafit akademik, përmbajtjes së sylabuseve, praktikës profesionale, etj. Pyetësorët, anketimet e kryera analizohen dhe pasqyrohen në raportet periodike të NJSBC. Ato dokumentohen deri në një afat të caktuar</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>E dëshmojmë se programi në fjalë ka marre analiza, vlerësime, krahasime, brenda departamentit dhe brenda institucionit, kjo referuar materialeve të NJSBC. Por meqënëse ky program akreditohet për herë të parë, nuk kemi arsye për të bërë krahasime me raporte akreditimi të mëparshme.</p> <p>GVJ konstaton se sigurimi i cilësisë realizohet përmes, monitorimit nga ana e strukturave drejtuese; tërheqjes së mendimit të studentëve me metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta; bashkëpunimit me patnerët; bashkëpunim me subjekte të tregut të punës etj.</p> <p><i>(Ref. 3.3.1.4 – Rregullore e NJSBC, Neni 4,5)</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njëjësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>E dëshmojmë që institucioni ka mjaftueshmërisht qartësi dhe seriozitet për një politikë dhe instrumenta të brendshëm që garantojnë cilësinë e programit në fjalë. Kjo politikë përpunohet dhe garantohet nga NJSBC. Përmes instrumenteve specifike, kjo zyrë rrit shkallën e interes të stafit për rëndësinë e cilësisë së programeve të studimit dhe nevojat e tregut për programin në fjalë. NJSBC harton raporte në mënyrë periodike. Këto raporte, janë burim potencial për vlerësimet dhe projektimet perspektive të programit në fjalë. Raportet e prodhura nga NJSBC, janë objekt në analizën vjetore të Senatit Akademik.</p> <p><i>(Ref. 3.3.1.3 – Raport i Fokus Grupeve të Studentëve, NJSBC Maj 2019;</i></p> <p><i>(Ref. 6.6.1.4 – Analiza e pyetësorëve të studentëve e NJSBC, Mars 2019)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

**Standardi VI.2**

**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Priremi të besojmë se NJSBC është mjaftueshëm serioze për të monitoruar dhe mbikëqyrur garantimin e cilësisë përgjatë përbushjes së programit. Kjo njësi sic edhe e theksua më sipër udhëheq me instrumente conform rregullors së institucionit dhe procesin e rishikimit të programit kur ka indikacione për të bërë këtë. NJSBC, periodikisht, në fillim sezoni siguron të dhëna që ngrihen mbi perceptimin e studentëve proceset e mësimdhënies, vlerësimit, detyrave të kursit, performancës së stafit akademik. Gjithashtu edhe njësi bazë luan një rol të rëndësishëm në këtë drejtim, e cila merr masa për zbatimin e detyrave sipas përcaktimeve në statut dhe detajimeve në dokumentat e tjera rregullatorë.</p> <p><i>(Ref dok nr. 6.6.1.1.1 – Vendim Senati Nr. 16 dt 27.02.2018 për ngritjen e NJSBC në UST)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Institucioni aplikon instrumente për të mbikëqyrur ecurinë e programit. Aplikimi i instrumenteve formal dhe jo formal, të drejtëpërdrejtë dhe të tërthortë, për të vjelë se çfarë studentët mendojnë, ndihmon të përbushet çek-blanc rreth asaj që realisht ndodh përgjatë programit. Pyetësorët janë një nga instrumentet që garanton informacion por dhe që mund të dokumentojnë qëndrimet e studentëve dhe mund të ruhen. Synimi është të “hetohet” tek cilësia e mësimdhënies, metodologjia, materialet didaktike, përditësimi i materialit, performanca e stafit, etj. Cdo instrument vlerësimi dokumentohet dhe është pjesë e raportit periodic të NJSBC.</p> <p><i>(Ref. 3.3.1.4 – Rregullore e NJSBC, Neni 4)</i></p> <p><i>(Ref 6.6.2.2 – Model pyetësori i NJSBC për studentët, Prill 2018)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>E konfirmojmë se NJSBC, ka fokus edhe çështje që lidhen me kalueshmërinë, notën mesatare për çdo disiplinë të programit të studimit. Për të përbushur këtë qëllim aplikon instrumente vlerësimi si: fokus grupe mix apo homogjene, intervista formale apo jo formale.</p> <p><i>(Ref. 6.6.2.3 – Raport i analizës së pyetësorit të NJSBC për studentët.</i></p> <p><i>(Ref 1.1.4.6 – Model Analize Vjetore Departamenti të</i></p>

	<i>Shkencave Sociale dhe Edukimit</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Konfirmojmë se: NJSBC, përpunon, grupon dhe klasifikon të dhënat e vjela nga instrumentet e vlerësimit, dhe i bën pjesë të raportit vjetor të institucionit. NJSBC i bashkëngjijt raportit edhe analizat e bëra në departamentet respektive dhe parashikon ndryshimet potenciale në program. Ky raport është periodik, i përmuajshëm dhe vjetor. Raporti prezantohet tek autoritetet e institucionit dhe dokumentohet.  <i>(Ref. 6.6.2.3 – Raport i analizës së pyetësorit të NJSBC për studentët.</i>  <i>(Ref.1.1.4.6 – Model Analize Vjetore Departamenti të Shkencave Sociale dhe Edukimit)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë	Konfirmojmë se: NJSBC përpunon pjesë të rëndësishme të raportit, sidomos rekomandime që vijnë nga studentët lidhur me aspektet e ndryshme të procesit të mësimdhënies, materialeve didaktike dhe procesi i nxënies.  Nga bashkëbiseda me anëtarë të NJSBC, nuk identifikua sygjerrime specifike të ardhura nga studentët për programin në fjalë.  <i>(Ref. 1.1.4.6 – Model Analize Vjetore Departamenti të Shkencave Sociale dhe Edukimit)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo	Konstatuam se: Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit funksionon seriozisht pas akreditimit institucional. Vlerësimi rreth ecurisë së programit është periodike dhe monitorohet nga NJSBC. Procesi i vlerësimit përmbushet kryesisht përmes pyetësorëve dhe anketave dhe zhvillohet çdo semester. Kjo do të thotë se kryhet dy herë në një vit akademik, gjithsej katër herë.. Në vijim të raporteve rekomandimeve të NJSBC, realizohen dhe relacione nga grupi i punës në rang departamenti për sigurimin e

<p>vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>brendshëm të cilësisë së programit. Departamenti evidenton problemet që lidhen me programin</p> <p><i>(Ref. 6.6.3.1 – Vendim Dekanati Nr. 5, dt. 16.01.2017, Mbi krijimin e Njesise per Sigurimin e Brendshem te Cilesise ne Fakultetin e Shkencave te Levizjes”</i></p> <p><i>(Ref. 6.6.2.3 – Raport i analizës së pyetësorit të NJSBC për studentët.</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Konstatuam se institucioni i jep mjaftueshëm seriozitet vlerësimit jo vetëm të programit por dhe performancës së studentëve. Për të përmbushur këtë aplikon metodologji të drejtëpërdrejta, të tërthorta për vlerësimin e disiplinave, që ofrohen në auditor, disiplinave specifike karakterizuese si: praktike/sportive, që i japin theksin Diplomës në këtë program. Studentët referuar rezultateve janë të lirë të parashtrajnë dhe mikro-teza. Stafit akademik i ka hapur horizontin studentëve të zgjellin midis temave me focus të ndryshëm disiplinuar apo ndërdisiplinuar kohe me pare, ne fillim te vitit akademik. Praktikant pedagogjike marrin mjaftueshëm vëmëndjen e stafit. Por, sic e konstatuam nga bashkebisedat, <i>mungon sistemi i mentorëve të certifikuar ku studentët përmbushin këtë pjesë substanciale të programit.</i> Ky fakt u konfirmua dhe nga Dekani, i cili kishte njohje të thelluar rreth sistemit të mentorëve dhe peshën që ata marrin në këtë program. Konstatuam se në institucion ka tashmë “kulture pune” sa i përket vlerësimit të programit, por, edhe vlerësimit të student/ve, si aspekt shumë substancial në një program.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtëpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitutionale apo kombëtare si provimi i shtetit për</p>	<p>E konfirmojmë se: institucioni aplikon metodologji mix për të bërë vlerësimin. Aplikon teste në sistem dhe të standardizuara dhe ekujvalente me shkolla si motra. Institucioni aplikon sistemin e vlerësimit me pikë dhe atë me notë. Ky sistem është i njohur për çdo studentë dhe gjëndet në rregulloren e institucionit. Cdo pedagog bën me dije studentët për sylabusin specifik se cili është raporti i pikëve brenda një sylabusi, në pjesën teorike, praktike dhe të performancës sportive dhe shëndetësore. Ky sistem pikëzimi bëhet duke ju referuar kopetencave profesionale që lipset të ketë një student që diplomohet në këtë fushë. Studentët vlerësohen për punën individuale dhe në grup. Ata i nënshtrohen proceseve vëzhguese dhe komentohen së bashku me stafin akademik.</p> <p><i>(Ref. 1.1.4.6 – Model Analize Vjetore Departamenti të</i></p>

profesionet e rregulluara dhe të tjera.	<i>Shkencave Sociale dhe Edukimit)</i>			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.	Gjatë bashkëbisedës me stafin akademik dhe me studentët, identifikua se: vlerësimi kishte disa fokuse, vecanarisht me fokus mësimdhënjen dhe kurrikulën. Ky proces kryesisht bëhej përmes pyetje konceptuale që conin tek arsytetime interesante që lidhej me thelbin e këtij programi dhe kësaj diplome dy dimensionale. Interesi i vlerësuesve conte kryesisht sa dhe si studentët kishin njohje dhe formim rreth diplomës me dy përmasa, atij të edukimit fizik dhe shëndetësor njëkohësisht. Studentët ngritën shqetësimin se në shkollat ku bënin praktikën, stafet nuk ishin mjaftueshëm të thelluar tek dija edukim fizik dhe shëndetësor., kjo ngre nëvojën për të ripar institucionin e mentorëve të certifikuar.  <i>(3.3.1.3 – Raport i Fokus Grupeve të Studentëve, NJSBC Maj 2019)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi VI.4

**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	E konfirmojmë se institucioni kishte të qarta politikat rreth perspektivës së programit si dhe procedurave që garantonin sigurimin e cilësisë. Grupet e përhershme që ndiqnin në rrugë formale ecurinë e programit dhe dokumentonin cdo dukuri që cfaqej gjatë dy vitve akademike e konfirmojnë pasjen e një politike adeguate në funksion të programit. Në mënyrë të vecantë aktorët e brendshëm, stafin, studentët dhe njësite logjistike ishin në sinkron të cdo veprimtarie në përmbushje të politikës institucionale për programin. Kërkesa e UST për të akredituar programin në fjalë, përgatitja e dosjes dhe e RVB nga institucioni, dëshmon se ka një politike të qartë institucionale për ta fuqizuar cilësisht programin në fjalë.  <i>(Ref6.6.1.1.1 – Vendim Senati Nr. 16 dt 27.02.2018 për</i>

	<i>ngritjen e NJSBC në UST)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Nga vizita në institucion si dhe vlerësimi i dokumentacionit GVJ konstatoi se Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët që angazhohen në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. Cdo hap inicuar në funksion të programit kalonte në vendimarrjen e strukturave respektive dhe dokumentohej. Detyrat dhe përgjegjësite e secilës strukturë ishin të parashikuara në rregulloren e institucionit.  <i>(Ref. 2.2.2.1 – Vendim Dekanati Nr. 52, dt. 01.10.2019, mbi Miratimin e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm të Programeve të Studimit në FSHL)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstatoi se në planin e veprimit të Senatit Akademik për sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtareve të personelit akademik, dhe ndihmës akademik. Në grupin vetvlerësimit ishte detyrim të merrte pjesë një student. Dekani ushqej me informacion të hollësishëm nga Departamenti dhe NJSBC.  <i>(Ref. 2.2.2.1 – Vendim Dekanati Nr. 52, dt. 01.10.2019, mbi Miratimin e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm të Programeve të Studimit në FSHL;</i>
<b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Konstatuam se grupet e vlerësimit të brendshëm ishin ciklike dhe të përfaqësuar në respekt dhe frymën e ligjit i cili, thekson të drejtën e përfaqësimit, pjesëmarrjes të palëve të interesuara. Institucioni i referohet rekomandimeve të bordit të akreditimit ASCAL, referuar detyrimit për kuatat për studentët me aftësi ndryshe, status të veçantë në respekt të gjinisë.  <i>(Ref – Vendim Bordi Administrimi ASCAL Nr.125, dt. 15.12.2017pë rirroganizimin e programit te studimit Master Profesional Mësuesi në EF e Shëndetësor në AP”, pika 3)</i>
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e	Bashkëbisedat e qëllimta na ndihmuan të kuptojmë se ka mardhënie reciproke me institucione të ngjashme, të cilat e kanë ushqyer programin në fjalë. Bashkëpunimet në trajtën e leksioneve me pedagogë nga Universiteti i . Elbasanit, Shkodrës, kanë rritur cilësinë dhe sofistikuar ambicjen në mësimdhënje. Referuar akreditimit të parë të institucionit dhe rekomandimeve të Bordit të Akreditimit të VBA, nr 64, dt. 21.09.2017 Senati i UST ka vendosur konsulente te jashtëm



mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj	të cilët zhvillojnë veprimtari asistuese, ndihmuese për aktivitete të veprimtarisë institucionale. <i>(Ref. 6.6.1.1.1 – Vendim Senati Nr. 16 dt 27.02.2018 për ngritjen e NJSBC në UST)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi VI.5

**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politikat institucionale janë lehtësisht të aksesueshme në dokumentat bazë të institucionit. Ato gjenden të mirëartikuluar në Statutin, rregulloren, strategjinë dhe në programin respektiv. Cdo dokument gjendet dhe elektronikisht nga të intresuarit. <i>(Ref. 1.1.1.1 – Statut i UST)</i>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	E konfirmojmë se gjithë procedurat për vlerësimin e objektivave të programit dhe të aktorëve që e përmbushin atë, janë të dokumentuara dhe gezojnë anonimitet të plotë. Institucioni respekton horizontalisht dhe vertikalisht parimet etike të komunikimit. Raportet e punës mësimore dhe kërkimore në tërësi i shpërndahen drejtuesve dhe në njësitë bazë diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë njësi. <i>(Ref. 4.4.6.4.2 – Raporti i Veprimtarisë Mësimore, Shkencore dhe Financiare, me Vendim Senati Nr. 45, dt. 24.12.2018 dhe Vendim Bordi Administrimi Nr. 36, dt. 24.12.2018)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Konstatuam se cdo raport vlerësimi kishte një strukturë që kishte fituar të drejtën e qytetarisë dhe ishte detyrimisht e zbatueshme: a. Identifikim i problematikave, b. adresim tek aktorët; c. plan perspektiv në funksion të përmirësimit të cilësisë; Cdo raport ndiqte rrugën hierarkike nga departamenti tek

	rektori.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	<p>E konfirmojmë që institucioni ka pikë të fortë procesin e vetëvlerësimit. Monitoron cilësinë, identifikon problematikat, vlerëson periodikisht dhe dokumenton cdo rezultat si dhe indikatorët që ka përdorur për të bërë vlerëimin. Kërkesa për akreditim drejtuar agjensisë ASCAL, është një hap serioz i institucionit, i cili ka realizuar RVB konform standardeve zyrtarisht ligjiore. Studentët konsiderohen si aktorët ku ballafaqohet cilësia e programit, ndaj ata janë periodikisht në fokus të vlerësimit, duke qënë aktorë dhe objekt i vlerësimit njëkohësisht. Mund të theksohet se Politikat financiare të institucionit janë relativisht të kënaqëshme.</p> <p><i>(Ref. 4.4.6.4.2 – Raporti i Veprimtarisë Mesimore, Shkencore dhe Financiare, me Vendim Senati Nr. 45, dt. 24.12.2018 dhe Vendim Bordi Administrimi Nr. 36, dt. 24.12.2018)</i></p> <p><i>(Ref 6.6.1.1 – Vendim BA Nr. 9 dt. 02.03.2018 për ngritjen e NJSBC në UST)</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit	<p>Konstatuam se Institucioni organizon takime periodike me stafin, studentët dhe strukturat në funksion të përmbushjes së programit si dhe njësitë administrative, financiare dhe logjistike. Degjesat dhe fokus grupet janë instrumene për të identifikuar problematikat. Transparenca financiare dhe mirëmbajtja e laboratorëve dhe mjediseve fizike konsiderohen po aq të rëndësishme për ecurinë e programit. Praktikrat profesionale kanë mjaftueshëm vëmëndjen e Institucionit megjithese janë konstatuar problematika të cilat janë pjese e shqetësimit të institucionit sic edhe është theksuar në pjeset e më sipërme të raportit.</p> <p><i>(Ref. 4.4.6.4.2 – Raporti i Veprimtarisë Mesimore, Shkencore dhe Financiare, me Vendim Senati Nr. 45, dt. 24.12.2018 dhe Vendim Bordi Administrimi Nr. 36, dt. 24.12.2018)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në: Mësuesi në Edukim Fizik e Shëndetësor në Arsimin Parauniversitar**

**a. Pikat e forta dhe afirmime;**

1. Konfirmojmë se Programi i studimit Master Profesional në “Edukim Fizik dhe Shëndetësor në arsimin parauniversitar” është hartuar në frymën dhe në përmbushje të plotë me kërkesat e ligjit;
2. Programi ofron diplomë ambicioze, ku pikëpriten më shumë se dy disiplina, edukimi fizik, dhe edukimi për shëndetin. Si e tillë, kjo diplomë, reflekton ekuilibrin e mjaftueshëm ndërdisiplinar. Diploma, rezonon me kurrikulën zyrtare, produkt (ish-IZHA), mbi të cilën funksionon ky dimension edukimi në arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë;
3. Programi Master Profesional në “Edukim Fizik dhe Shëndetësor arsimin parauniversitar” i përgjigjet një kërkesë të identifikuar në tregun e punës. Pas vendimit të MASR, “Edukimi Fizik e Shëndetësor”, fitoi hapësira të reja në planin mësimor, nga dy në tri orë mësimore në javë, duke bërë legale nevojën për të ri-konceptuar një kurrikul të re;
4. Programi operon mbi një repertor të gjerë disiplinash që thellojnë dijen rreth shëndetit dhe dijen rreth edukimit fizik. Programi, synon ta ngrejë në nivelin e kulturës individuale dhe kuptimit për veten si repertor sjellor dhe dimension social edukimi;
5. Format e vlerësimit të programit dhe jo vetëm të programit, garantojnë cilësinë e tij për gjatë procesit. Instrumentet e vlerësimit janë mix dhe operojnë në rrafshin: vertikal, horizontal, periodikisht, mbështetur në indikatorë të aksesueshëm;
6. Staf i akademik i brendshëm mbulon programin dhe gëzon titujt dhe gradat akademike në përmbushje të detyrimeve ligjore;
7. Programi ka qëndrueshmëri përmbajtësore, logjistike dhe financiare;

**b. Pika të dobta:**

1. Praktika profesionale në programin e studimit Master Profesional në “Edukim Fizik dhe Shëndetësor në arsimin parauniversitar”, merr peshë specifike. Por kjo pjesë e programit megjithëse konsiderohet substanciale, nuk përmbushet në cilësinë e duhur. Kjo për disa arsye:
  - a. Mungon sistemi i mentorëve të certifikuar që mentorojnë gjithë praktikën deri në përfundim;
  - b. Mësuesit që zhvillojnë këtë disiplinë në shkolla aktualisht, kanë një formim relativisht të zbehtë në dimensionin e shëndetit, kjo dhe për faktin se në shumicën e tyre ata janë të diplomuar në Edukim Fizik. Ky fakt u konstatua dhe nga studentët në bisedë. Praktika përgjithësisht, zhvillohet në të njëjtin institucion edukimi ku studenti/ja është i punësuar dhe vlerësimi bëhet po nga titullari i institucionit;
2. Në thuajse asnjë silabus nuk vjen sistemi kurrikular i arsimit parauniversitar dhe hapësira që Edukimi Fizik dhe Shëndetësor zë brenda kësaj kurrikule. Mungojnë dijet e edukimit fizik dhe edukimit shëndetësor të përthyer në kopetencë mësimdhënieje, referuar kurrikulës zyrtare;

**Rekomandime:**

1. Referuar praktikës profesionale: sygjerojmë, identifikimin e një liste me mentorë, individë me profil të spikatur në mësimdhënien e kësaj disipline, si dhe të certifikuar nga UST dhe të mirëmbajtur po nga Institucioni;

2. Referuar titullit të diplomës që ky program lëshon, sygjerojmë të identifikohet mundësia që brenda hapësirës që lejon ligji, të atashohet ose ti bashkëngjitet një disiplinë të përafërt, kurrikula zyrtare e Edukimit Fizik dhe Shëndetësor në gjithë ciklet e shkollimit në Republikën e Shqipërisë si: hapësira në planin mësimor, pësia që zë në sistemin e arsimit parauniversitar, përthyerja e dijes kurrikulare në kopetencia mësimdhënie. Kjo është e mundëshme dhe e domosdoshme;

**Conclusions of the Evaluation Process of the study program “Professional Master in: “Teacher in physical and health education in pre-university education”**

**a. Strengths and affirmations:**

1. We confirm that the Professional Master’s Degree Program in “Physical and Health Education in Pre-university Education” is designed in the spirit and in full compliance with the requirements of the law;
2. The program offers an ambitious degree, covering more than two disciplines, physical education and health education. As such, this degree reflects sufficient interdisciplinary balance. The diploma resonates with the official curriculum, a product (formerly IZHA), on which this dimension of education in pre-university education in the Republic of Albania functions;
3. The Professional Master’s program in “Physical and Health Education pre-university education” responds to an identified demand in the labor market. Following MASR’s decision, “Physical and Health Education” gained new curriculum space, from two to three teaching hours per week, legitimizing the need to re-conceptualize a new curriculum;
4. The program operates on a wide range of disciplines that deepen knowledge about health and knowledge about physical education. The program aims to raise the level of individual culture and understanding of oneself as a behavioral repertoire and social dimension of education;
5. Forms of program evaluation, and not just the program, guarantee its quality during the process. Assessment instruments are mix and operate in the field: vertical, horizontal, periodically, based on accessible indicators;
6. Fulltime academic staff covers the program and enjoys academic degrees and titles in fulfillment of legal obligations;
7. The program has substantive, logistical and financial sustainability.

**b. Weaknesses:**

1. Professional practice in the Professional Master’s study program in "Physical and Health Education in Pre-university Education", receives specific weight. But this part of the program, although considered substantial, is not fulfilled in its proper quality. This for several reasons:
  - a. There is no system of certified mentors who mentor the whole practice until the end;
  - b. Teachers who develop this discipline in schools currently have a relatively dim education in health, due to the fact that in most of them they are graduates of Physical Education. This fact was also confirmed by the students. The internship is generally conducted in the same

educational institution where the student is employed and the assessment is made by the head of the institution;

2. Almost no syllabus comes with the curriculum of the pre-university education and the space that Physical and Health Education occupies within this curriculum. There is lack of knowledge about physical education and health education translated into teaching competencies, at least based on the official curriculum;

**Recommendations:**

1. Referring to professional practice: we suggest identifying a list of mentors, individuals with a prominent profile in teaching this discipline, as well as certified by UST and maintained by the Institution;
2. Referring to the diploma title that this program issues, we suggest identifying the possibility that within the space allowed by law, to be attached to an approximate discipline, the official Physical and Health Education curriculum throughout the education cycle in the Republic of Albania as: curriculum space, the weight it occupies in the pre-university education system, translating curricular knowledge into teaching competencies. This is possible and necessary.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI, I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE,				X

<b>FINANACIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof. Asoc. Marjana SINANI**

**Dr. Genc BURAZERI**